



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
KRYETARI

Rruga "Abdi Toptani", Nr. 1,

www.klsh.org.al E-mail: klsh@klsh.org.al

Nr 201/14 Prot.

Tiranë, më 29/ 10 / 2018

V E N D I M

Nr. 150, Datë 29 / 09 / 2018

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË MINISTRINË E MBROJTJES, TIRANË ME OBJEKT: " AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE", PËR PERIUdhËN 01.01.2015 DERI MË DATËN 31.12.2017.

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes, me objekt "Auditim Përputhshmërie", për periudhën 01.01.2015 deri në 31.12.2017, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim opinion kundërshtues.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes me objekt "Auditim Përputhshmërie", për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT:

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Mbrojtjes është mbështetur në: ligjin nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të auditimit "ISSAI 400"; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmerisë nga subjekti Ministria e Mbrojtjes të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale konsistojnë:

Në drejtim të hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit jo në përputhje me ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjeve vjetore të buxheteve përkatës; në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm publik jo në përputhje me ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; në drejtim të prokurimit publik jo në përputhje me ligjet që rregullojnë fushën e prokurimeve publike; në drejtim të rritjes në një nivel më të lartë të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit menaxherial, në drejtim të hartimit të rregullave të brendshme për gjurmët e auditimit në funksion të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi; në drejtim të përmirësimeve të rregullave dhe projekt-akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Institucionit në funksion të ekonomicitet, eficensë dhe efektivitet të fondeve buxhetore.

Përgjegjësit e menaxhimit të ministrisë janë:

Hartimi, ekzekutimi, monitorimi dhe raportimi i buxheteve të ministrisë në përputhje me rregullat e menaxhimit të sistemit buxhetor; menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm publik në përputhje me rregullat për menaxhimin financiar dhe kontrollit, realizimi i prokurimeve publik në përputhje me rregullat e prokurimeve publike, hartimi dhe përmirësimi i rregullave dhe projekt-akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes për përdorimin me ekonomicitet, eficensë dhe efektivitet të fondeve buxhetore. Si pasojë e keq menaxhimit janë evidentuar nga audituesit devijime dhe shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale, ku ndër më kryesoret do të veçonim:

-Në fushën e shpenzimeve operative të kryera nga përfaqësitë ushtarakë të kuadruara në vendet e huaja, për shkak të shkeljes së akteve ligjore e nënligjore, në disa raste i është shkaktuar buxheti të shteti dem ekonomik në vlera që shkojnë rreth 27,240,000 lekë.

-Në fushën e prokurimeve publike për qëllime ushtarake dhe të prokurimeve të klasifikuara sekret shtetëror, janë rritur kostot buxhetore në dem të buxhetit të shtetit në vlerën 1,08 miliard lekë.

-Në fushën e prokurimeve publike civile, për shkak të shkeljeve të LPP i është shkaktuar buxheti të shtetit dem ekonomik në vlerën 39,492,823 lekë dhe rritje të kostove buxhetore në dem të buxhetit të shtetit në vlerën 68,817,930 lekë.

Përgjegjësit e audituesit janë:

Grupi i auditimit ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) dhe konkretisht ISSAI 4000 “*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*”. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë*”, pjesë e raportit tonë (faqja 4). Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura me siguri të arsyeshme, por nuk garantojmë që auditimi i kryer në përputhje me këto standarde mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mundë të ekzistojë. Gjithashtu, besojmë se, dëshmitë dhe evidencat e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat e arsyeshme për arritjen në opinionin e auditimit.

Opinionit auditimit:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standartet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Mbrojtjes u konstatuan devijime dhe

shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën *japim opinion kundërshtues*¹.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME LIGJORE:

1. Gjetje. Ministria e Mbrojtjes gjatë periudhës objekt auditimi ka realizuar procedura prokurime civile prokurime ushtarake dhe procedura prokurimi të klasifikuara “*sekret shtetëror*”.

Procedurat e prokurimi civile për mallra shërbime dhe punë janë zhvilluar nëpërmjet sistemit elektronik, në zbatim të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, procedurat prokurimi për qëllime ushtarake për mallra shërbime dhe pune, janë zhvilluar me procedurë me negociim të drejtpërdrejte apo të kufizuar në zbatim të VKM nr. 521 datë 08.08.2007 “Për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe procedurat e prokurimit “*sekret shtetëror*” për mallra shërbime dhe pune janë zhvilluar me negociim të drejtpërdrejte apo të kufizuar në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe VKM nr. 701, datë 22.10.2014 “Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”.

Nga analizimi i të dhënave mbi këto procedura prokurimi të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi (*të trajtuara më poshtë pikën C, Masa Organizative,*) tregohet qartë se, në procedurat që i janë nënshtruar ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, pra janë zhvilluar në sistemin elektronik të APP, efekti i garës nga konkurrenca është dukshëm pozitiv dhe kjo tregohet mbi të gjitha në kursimin e fondeve që shkon nga 19 % deri në 40%. Ndërsa për procedurat që nuk i nënshtruar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, pra nuk janë zhvilluar në sistemin elektronik të APP, por me “*Zarfa në dorë*” efekti i garës nga konkurrenca, është dukshëm negative, çka tregohet mbi të gjitha në fitimin e tenderëve me vlerë të plotë dhe kursimi i fondeve në këto raste është 0.2% deri në 0.7%. Risku në procedurat e prokurimeve ushtarake dhe të klasifikuara sekret “I Kufizuar” në krahasim me procedurat prokurimit sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 është shumë i lartë sepse në këto procedura negociohet direkt me operatorin të parazgjedhur fitues. Duhet theksuar se, të gjitha procedurat e prokurimit si ato civile, ushtarake apo sekrete janë realizuar nga të njëjtët Komisione të Hartimit të DT dhe të njëjtët Komisione Vlerësimi të Ofertave. Për të nxjerrë në dukje efektet negative që kanë ardhur në dëm të buxhetin e shtetit si pasoje e punës me dy standarde të Autoritetit Kontraktor, morëm në analizë duke ilustruar, disa zëra konkrete të disa mallrave shërbimeve dhe punëve të realizuara nëpërmjet procedurave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe i krahasuam me të njëjtat zëra të disa mallrave shërbimeve dhe punëve të realizuara nëpërmjet procedurave ushtarake dhe sekrete. Nga ky krahasim dhe llogaritje rezultoi se, kostot e mallrave, shërbimeve dhe punëve të realizuara me procedurat e prokurimeve ushtarake dhe të klasifikuara sekret “I Kufizuar” janë minimalisht, rreth 10-20% ose në vlerë rreth **1 miliard lekë** më të larta, për shkak se, këto mallrave, shërbimeve dhe punë nuk janë prokuruar nëpërmjet sistemit elektronik të APP (në vitin 2015, rreth 120 milion lekë, në vitin 2016, rreth 240 milion lekë dhe në vitin 2017 rreth 640 milion lekë). Nisur nga këto probleme, kërkohet në mënyrë imediate marrja e një sërë masave për përmirësime ligjore sepse është pikërisht baza ligjore që lejon realizimin e procedurave pa konkurrencë, vakumi i të cilave është shfrytëzuar mjaftë mirë nga AK, duke sjell kështu, efekte negative të konsiderueshme në dëm të buxhetit të shtetit (*trajtuar më hollësisht në faqet 67-73 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

1. Rekomandim:

Hartimin e një projekt-ligji të veçantë për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë duke u

¹ Sipas *Manualit të Auditimit Përputhshmërisë* të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.5, Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar, kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transakcionet në fjalë.

bazuar në Direktivën e BE-së për Prokurimin në fushën e Mbrojtjes dhe në ligjit nr.9642, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. Ky projekt-ligj duhet të synoj:

- Procedura fleksibël prokurimi, rregullat e kualifikimit, përzgjedhjes, shpalljes së fituesit dhe kushtet e realizimit të kontratës të përshtatura me nevojave kombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë.

-Një kuadër i qartë dhe transparent të prokurimit për të nxitur konkurrencën dhe vlerën për para;

-Pajtueshmëria me ligjin e prokurimit publik të BE-së dhe me praktikat më të mira të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë;

-Çmime më të ulëta dhe cilësi më të mirë të mallrave, shërbimeve dhe punëve të prokuruar, dhe standardizimin e vlerave të kontratave, duke pasur prioritet vlerat e kontratave të mëparshme të realizuara nga MM apo institucione të tjera, në zbatim të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

-Shqyrtim të pavarur të ankesave të operatorëve ekonomik, dhe të paktën të drejtën e ankimit dhe shqyrtimit të tyre nga komisioni i prokurimit publik apo në një shkallë të dytë e gjyqësorit.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

C. REKOMANDIME PËR MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje. Ministria e Mbrojtjes gjatë periudhës objekt auditimi ka realizuar procedura prokurime civile prokurime ushtarake dhe procedura prokurimi të klasifikuara *sekret shtetëror*, si më poshtë:

1.1. Procedurat e prokurimi për mallra shërbime dhe punë të realizuara në zbatim të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”:

-Në vitin 2015 në 29 raste me fond limit në vlerën 1,078,534,329 lekë dhe janë lidhur 29 kontrata në vlerën 840,883,149 lekë. Janë kursyer 327,651,180 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 22% e fondit limit.

-Në vitin 2016 në 48 raste me fond limit në vlerën 1,777,360,822 lekë dhe ka 48 lidhur kontrata në vlerën 1,062,626,399. Janë kursyer 714,734,423 lekë fonde buxhetore ose është kursyer 40% e fondit limit.

-Në vitin 2017 në 29 raste me fond limit në vlerën 1,118,311,719 leke dhe ka 29 lidhur kontrata në vlerën 904,153,150 lekë. Janë kursyer 214,158,570 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 19% e fondit limit.

1.2. Procedurat prokurimi për mallra shërbime dhe pune të realizuara për qëllime ushtarake:

-Në vitin 2015 në 5 raste me fond limit në vlerën 483,262,375 lekë dhe ka lidhur 5 kontrata në vlerën 427,482,350 lekë. Janë kursyer 55,780,025 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 11.5% e fondit limit.

-Në vitin 2016 në 12 raste me fond limit në vlerën 1,786,316,355 lekë dhe ka lidhur 12 kontrata në vlerën 1,782,466,020 lekë. Janë kursyer 3,850,335 lekë fonde, ose është kursyer 0.2% e fondit limit.

-Në vitin 2017 në 6 raste me fond limit në vlerën 4,712,951,520 lekë dhe ka lidhur 6 kontrata në vlerën 4,696,189,110 lekë. Janë kursyer 16,762,410 lekë fonde, ose është kursyer 0.3% e fondit limit.

Të gjitha këto procedura janë zhvilluar me procedurë me negociim të drejtpërdrejte apo të kufizuar në zbatim të VKM nr. 521 datë 08.08.2007 “Për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit Publik”, i ndryshuar. Siç shihet efektivitetin e këtyre procedurave nga realizimi i prokurimeve është pothuajse minimal.

1.3. Procedurat e prokurimit të realizuara, “*sekret shtetëror*”:

-Në vitin 2015 në 10 raste me fond limit në vlerën 549,230,000 lekë dhe ka lidhur 10 kontrata në vlerën 545,779,000 lekë. Janë kursyer 3,451,000 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 0.6% e fondit limit.

-Në vitin 2016 në 8 raste me fond limit në vlerën 270,285,000 lekë dhe ka lidhur 8 kontrata në vlerën 268,395,000 lekë. Janë kursyer 1,890,000 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 0,7% e fondit limit

-Në vitin 2017 në 8 raste me fond limit në vlerën 477,431,000 lekë dhe ka lidhur 8 kontrata në vlerën 474,179,000 lekë. Janë kursyer 3,252,000 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 0.7% e fondit limit.

Të gjitha këto procedura janë të klasifikuara në nivel sekret “I kufizuar” dhe janë realizuar në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe VKM nr. 701, datë 22.10.2014 “Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”. Të gjitha procedurat janë zhvilluar me procedurë me negociim të drejtpërdrejtë apo të kufizuar në zbatim të VKM nr. 701, datë 22.10.2014 të sipërcituar. Edhe në këto procedura efektivitetin i prokurimeve është pothuajse 0 (zero).

Siç tregojnë të dhënat e mësipërme, për procedurat që i janë nënshtruar ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, pra janë zhvilluar në sistemin elektronik të APP, efekti i garës nga konkurrenca është dukshëm pozitiv dhe kjo tregohet mbi të gjitha në kursimin e fondeve që shkon nga 19 % deri në 40%. Ndërsa për procedurat që nuk i nënshtruar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, pra nuk janë zhvilluar në sistemin elektronik të APP, por me “Zarfa në dorë” efekti i garës nga konkurrenca, është dukshëm negative, çka tregohet mbi të gjitha në fitimin e tenderëve me vlerë të plotë dhe kursimi i fondeve në këto raste është 0.2% deri në 0.7%. Risku në procedurat e prokurimeve ushtarake dhe të klasifikuara sekret “I Kufizuar” në krahasim me procedurat prokurimit sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 është shumë i lartë sepse në këto procedura negociohet direkt me operatorin të parazgjedhur fitues. Duhet theksuar se, të gjitha procedurat e prokurimit si ato civile, ushtarake apo sekrete janë realizuar nga të njëjtët Komisione të Hartimit të DT dhe të njëjtët Komisione Vlerësimi të Ofertave. Për të nxjerrë në dukje efektet negative që kanë ardhur në dëm të buxhetin e shtetit si pasojë e punës me dy standarde të Autoritetit Kontraktor, morëm në analizë duke ilustruar, disa zëra konkrete të disa mallrave shërbimeve dhe punëve të realizuara nëpërmjet procedurave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe i krahasuam me të njëjtat zëra të disa mallrave shërbimeve dhe punëve të realizuara nëpërmjet procedurave ushtarake dhe sekrete. Nga ky krahasim dhe llogaritje rezultoi se, kostot e mallrave, shërbimeve dhe punëve të realizuara me procedurat e prokurimeve ushtarake dhe të klasifikuara sekret “I Kufizuar” janë minimalisht, rreth 10-20% ose në vlerë rreth 1 miliard lekë më të larta, për shkak se, këto mallrave, shërbimeve dhe punë nuk janë prokuruar nëpërmjet sistemit elektronik të APP (në vitin 2015, rreth 120 milion lekë, në vitin 2016, rreth 240 milion lekë dhe në vitin 2017 rreth 640 milion lekë). Nisur nga këto probleme, kërkohet në mënyrë imediate marrja e një sërë masave për përmirësime ligjore sepse është pikërisht baza ligjore që lejon realizimin e procedurave pa konkurrencë, vakumi i të cilave është shfrytëzuar mjaftë mirë nga AK, duke sjell kështu, efekte negative të konsiderueshme në dëm të buxhetit të shtetit (*trajtuar më hollësisht në faqet 67-73 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

1.Rekomandim:

MM, deri në miratimin e akteve ligjore e nënligjore që do të rregullojnë prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, në çdo procedurë prokurimi për qëllime ushtarake apo i klasifikuar sekret “I kufizuar” që do të realizohet në vazhdim , vlera e kontratës të llogaritet, bazuar në vlerat e kontratave të mëparshme, nëse MM apo institucione të tjera kanë realizuar nëpërmjet sistemit elektronik të APP në zbatim ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Deri në miratimin e akteve ligjore

2. Gjetje. Në dy procedura prokurimi ushtarake të realizuara në zbatim të VKM nr. 521 datë 08.08.2007, u konstatua:

2.1. Procedura e prokurimit me objekt “Sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë (SIVHA), Faza I, shtrirë në vitet buxhetore 2017-2019”, me fond limit 22,266,000 USD me “Procedurë me negociim të drejtpërdrejtë realizuar në vitin 2017.

Në funksion të rëndësisë që ka ky projekt do të mbështetet nga buxhetin e shtetit dhe fondin financiar të akorduar nga Qeveria e SHBA-së në vlerën 3,127,000 USD, me detyrimin që

konsulenca të bëhet nga Departamenti i Mbrojtjes së SHBA dhe implementues i projektit të jetë një kompani amerikane me të cilën ai bashkëpunon. Në vijim të implementimit të projektit, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes është ngritur grupi i punës për hartimin e propozimit teknik, projektit dhe analizën e kostos. Drejtoria e Standardeve dhe Modernizimit (DSM) në përfundim të punës ka paraqitur propozimin teknik paraprak i cili është miratuar nga Bordi i Modernizimit duke i rekomanduar Ministrit të Mbrojtjes që për zhvillimin e mëtejshëm të këtij projekti, kërkohet asistencë e kualifikuar nga Departamenti i Mbrojtjes së SHBA. Në vijim, Departamenti i Mbrojtjes së SHBA rekomandon asistencën e kualifikuar të kompanisë “L. M. ”, USA. Më pas i është dërguar kompanisë “L.M”, “kërkesa për çmim dhe disponueshmëri”. Kompania ka dërguar disponueshmërinë dhe kuotimet përkatëse për instalimin e radarit të fazës së parë të projektit SIVHA. Vlera totale e fondit limit, bazuar në ofertën e paraqitur nga kjo kompani është 22,266,000 USD. Procedura e prokurimit është përzgjedhur “Procedurë me negociim të drejtpërdrejtë”. Me shkresë zyrtare, ju dërgua ftesa për ofertë së bashku me dokumentet e tenderit, kompanisë së përzgjedhur “L. M”, USA.

Në vijim të procedurës, kompania ka paraqitur një kërkesë për ndryshime në dokumentet e tenderit e cila konsiston në lejimin e nën kontraktimit vetëm për elementë të infrastrukturës dhe ndërtimit e cila sipas preventivit është në vlerën 2,822,000 USD (*trajtuar më hollësisht në faqet 128-129 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

2.2. “Kompletimi me uniforma stërvitje e materiale të tjera pjesë e kësaj uniforme për strukturat ushtarake të FA-së”, për periudhën 2018-2021, me fond limit në vlerën 1,483,395,642 lekë, realizuar në vitin 2017.

Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes është ngritur grupi i punës për studimin e disponueshmërisë dhe analizës së kostos për blerjen e uniformave të stërvitjes e materialeve të tjera, pjesë e kësaj uniforme për strukturat ushtarake të Forcave të Armatosura. Grupi i punës pasi studioj faqe të ndryshme të ueb-siteve të disa kompanive të huaja prodhuese të cilat operojnë në këtë fushë vendosi të dërgoj në rrugë zyrtare dhe elektronike kërkesën për çmime dhe disponueshmëri 7 kompanive. Kërkesës për çmim dhe disponueshmëri i janë përgjigjur të 7 kompanitë, duke sjellë çmimet e tyre. Gjashtë nga këto kompani kanë dërguar çmimet për të gjithë artikujt e kërkuar, ndërsa kompania “K.”, Itali ka dërguar çmimet vetëm për artikujt e këpucëve të cilat i kishte paraqitur me çmime më të ulta se, të gjashtë kompanitë e tjera. Grupi i punës vendosi që çmimet për llogaritjen e fondit limit të jenë mesatarja e çmimit të kontratës së mëparshme; çmimit mesatares së nxjerrë nga kompanitë /distributorët online; çmimit mesatar i kompanive të zgjedhura për çmim dhe disponueshmëri dhe në përfundim, llogaritja e fondit limit në vlerën 1,483,395,642 lekë. Po kështu ka sugjeruar që procedura e prokurimit të zhvillohet e “Kufizuar” me pjesëmarrjen e **të 7 kompanive që u kërkojë çmime dhe disponueshmëri**. Në vijim, është miratuar prokurimi i këtij projektit nga Ministri i Mbrojtjes dhe nga DSM është dërguar i gjithë praktika dokumentare e prokurimi në DAP për të vijuar me zhvillimin e procedurës së prokurimit. Kjo Drejtori, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dërguar i ka kërkuar DSM disa sqarime dhe plotësim dokumentacionit të kësaj procedure. Ndër sqarimet me kryesore është: *“shoqëria “K.”, Itali e cila ka dhënë ofertë për artikujt që zënë një vlerë përafërsisht 30% të fondit limit, çka vë në diskutim edhe mundësinë e nën kontraktimit për pjesën tjetër të artikujve, pasi referuar “Kushteve të përgjithshme të Kontratës”, pjesë e DST që aplikon AK, nën kontraktimi lejohet për një vlerë jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës....”*?. DSM, mori në konsideratë këtë sqarim dhe bëri një ndryshim në propozimin e mëparshëm duke mos e ftuar këtë shoqëri për të paraqitur ofertën e saj, pra nga 7 kompani ftoi për të paraqitur ftesën për ofertë vetëm 6 kompani. Mirëpo argumentim i AK, për mos të ftuar kompaninë “K.I”, Itali në procedurën e prokurimit është bërë në interpretime të gabuara të VKM nr. 521, date 8.8.2007 i ndryshuar, sepse, siç u trajtua më lartë, sipas pikës 1 të kreut VII të kësaj VKM që bënë fjalë për “Ekzekutimin e kontratës”, nën kontraktimi behet nga operatori që del fitues dhe që me dorëzimin e ofertave duhet të deklarojë punët shërbimet ose mallrat që ka për qëllim të nënkontrakttojë në rast se ai do të shpallet fitues. Pra nën kontraktorët nuk marrin pjesë në

konkurrim (prokurim) por ofertuesi duhet ta deklaroje që një pjesë të kontratës do ta japi me nën kontraktim. Pra, kompanisë “K.I”, Itali, duhej ti dërgohej ftesa për ofertë, dhe në rast se, ajo gjykonte për të marrë pjesë në prokurim, për artikujt e tjerë që nuk kishte paraqitur çmime dhe disponueshmëri, fare mirë mundë të bënte bashkim operatorësh, ashtu siç ka bërë edhe kompania fituese të cilës i është dërguar ftesa për ofertë e vetme, por në prokurim është paraqitur si bashkim i tre operatorëve dhe KVO e ka shpallur fitues edhe pse VKM nr. 521, date 8.8.2, ndryshe nga rregullat e prokurimeve civile nuk parashikon rastet e bashkimit të shoqërive në një të shoqëri të vetme. Konkretisht, në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 18.12.2017, paraqitën dhe dorëzuar oferta vetëm 3 (tre) Kompani: “L.S” me ofertë në vlerën 1,481,013,520 lekë, BOE “D.P&M.&A”, me ofertë në vlerën 1,479,495,980 lekë dhe “A..” me ofertë në vlerën 1,481,173,150 lekë. Është shpallur fitues me të cilin është lidhur dhe kontrata e furnizimit BOE “D.P&M.&A”, me ofertë në vlerën 1,479,495,980 lekë, pa TVSH. Por, për shkak të mos dërgimit të i ftesës për ofertë të kompanisë “K.I”, Itali, grupi i auditimit mori në analizë, çmimet dhe vlerat e artikujve të këpucëve, sipas ofertës fituese dhe i krahasoi me çmimet e kompanisë “K.I”, Itali të paraqitur në kërkesën për çmime dhe disponueshmëri dhe rezultoi se, çmimet e artikujve të këpucëve të kësaj kompanie ishin rreth 80 milion lekë më të ulta se çmimet e artikujve të këpucëve të ofertës fituese BOE “D.P&M.&A”, . Për pasojë nga mos marrja pjesë në mënyrë të padrejtë të kompanisë “K.I”, Itali mund të ishte ulur kosto e blerjes së këtyre materialeve ushtarake në **vlerën rreth 80 milion lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 121-128 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

2.Rekomandim:

MM, në çdo procedurë prokurimi që do të realizohet, në këto raste të veçanta, deri në miratimin e akteve ligjore e nënligjore që do të rregullojnë prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, në Dokumentet e Tenderit, të vendoset lejimi i Bashkimit të Operatorëve Ekonomik.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Deri në miratimin e akteve ligjore

3. Gjetje: Aktualisht, numri i helikopterëve që ka në TOP Forca Ajrore (FAj) është 25 (TOP është tabelë që tregon mjetet e deklaruara që janë përfshirë në regjistrin ligjor për shfrytëzim/përdorim nga FAj. Për mjetet jashtë TOP, ligjërisht, nuk lejohet të vihen në përdorim dhe nuk mund të kryesh shpenzime për to). Nga të dhënat (e mirëmbajtjes të helikopterëve, për vitet 2014 – 2017) rezulton se numri maksimal i helikopterëve në gatishmëri operacionale ka arritur në 8 helikopter . Gatishmëria kaq e ulët, është e lidhur kryesisht:

Me numrin e lartë të tipeve të helikopterëve (janë *tre linja/ teknologji prodhimi* dhe dhjetë tipe të ndryshëm), vjetërsinë (moshën) e tyre, e cila shoqërohet me shpenzime të mëdha financiare për mirëmbajtjen (në vitin 2017 për mirëmbajtjen rutinë, niveli më i ulët, janë shpenzuar rreth 139,000 mijë lekë).

Shpenzimet për këto mjete bëhen më pak efektive duke pasur në konsideratë se krahas shpenzimeve direkt për blerjen, janë shpenzuar fonde të konsiderueshme për kualifikimin e personelit dhe reduktimi i tipit të mjeteve, ka bërë që efektiviteti i shpenzimeve të jetë edhe më i ulët. Për çdo tipi helikopteri, kërkohet kualifikim dhe pajisje/vegla pune të kushtueshme të veçanta për personelin.

Kjo shumëllojshmëri, rrit më tej kostot pasi për tipet e vjetër pjesët e këmbimit nuk gjenden, kanë çmime të larta etj, por njëkohësisht nuk lejon/krijon mundësinë që pjesët e këmbimit të rregullta të një mjeti të reduktuar, ose jo në gatishmëri, të përdoren nga një mjet tjetër, me pasojë rritjen e numrit të mjeteve që nuk janë në punë (trajtuar më hollësisht në faqet 129-132 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

3.Rekomandim:

Blerja e mjeteve ajrore të mbështetet në nevojat që ka vendi, në përmbushje edhe të detyrimeve ndaj objektivave dhe standardeve të NATO, por mbi të gjitha, në mundësitë financiare për mirëmbajtjen periodike deri në një periudhë kohore të pranuar teknikisht për këto mjete. Nën këtë arsyetim, për të rritur efektivitetin e shpenzimeve, është e nevojshme që Institucioni, të blejë aq mjete sa ka

mundësi t'i mirëmbajë. Blerja e mjeteve të orientohet në kufizimin e mundshëm të linjave të prodhimit deri në dy dhe tipologjisë së mjeteve deri në katër tipe, çka që do të thotë një reduktim të tipeve në masën rreth 58 për qind kundrejt numrit aktual të mjeteve.

Në vetvete, kufizimi i tipeve të helikopterëve, ka efekt të drejtpërdrejtë në uljen e numrit të personelit mirëmbajtës, shpenzimeve për pajisjen e tyre me mjete pune etj, duke bërë të mundur që me të njëjtën vlerë (para) në dispozicion, të realizohet mirëmbajtje më e mirë për mjetet e tjera, duke rritur realisht numrin e mjeteve në gatishmëri.

Zëvendësimin gradual me helikopterë të rinj, nëpërmjet vlerësimit teknik për heqjen nga përdorimi të mjeteve që kanë plotësuar ciklin jetësor. Zëvendësimi i helikopterëve të vjetër paraqitet si domosdoshmëri ekonomike, pasi kosto e mirëmbajtjes së tyre në vite rritet ndjeshëm, duke kaluar vlerën e blerjes së mjetit dhe duke bërë të paleverdishëm mirëmbajtjen e mëtejshme të tyre. Ndërkohë, blerja e helikopterëve të rinj do të sjellë jo vetëm reduktimin e kostos financiare të mirëmbajtjes së tyre, por do të rrisë/garantojë ndjeshëm cilësinë dhe kapacitetet operacionale të kryerjes së misioneve/detyrave të tyre.

Mirëmbajtja e mjeteve dhe përgatitja e personelit, të orientohet drejt marrëveshjeve shtetërore me vendet e NATO-s, me qëllim, jo vetëm uljen e çmimit, por edhe shmangien e abuzimeve të mundshme.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

4.Gjetje . Shërbimi i mirëmbajtjes/riparimit të helikopterëve, parashikohet të kryhet për periudha kohore një vjeçare buxhetore dhe kalon nëpërmjet 18 hapave procedurale, që minimalisht të marrin 5 ditë (ka dhe hapa me nga 20-25 ditë) dhe koha e humbur vetëm për shkak të zhvillimit të procedurës së tenderit llogaritet 3-6 muaj, nga kërkesa operacionale që bëhet F. Aj, deri në lidhjen e kontratës në MM. Mjeti për të qenë në gatishmëri është I kushtëzuar nga plotësimi I njëhershëm ose kush mbush orët e punës (100 orë) ose kohës kalendarike (një vit sipas manualeve të konstruktorit). Normalisht shfrytëzimi normal i helikopterit kërkon që të shkojnë paralelisht orët e punës me afatet kalendarike, kështu, helikopteri quhet i shfrytëzuar maksimalisht sipas manualeve. Duke marrë në konsideratë këto afate, vonesa deri 6 muaj do të thotë:

- eficiencë deri 50 për qind më pak e helikopterit, e cila përkethehet në humbje financiare, pasi helikopteri do të shfrytëzohet vetëm 6 muaj (shpenzimet fikse janë njëlloj) dhe në vijim do të kërkojë mirëmbajtjen e ardhshme 1 vjeçare.

- Ulje të përqindjes së gatishmërisë të mjeteve ajrore, ulje e kohës së punës/trajnitimit të efektivëve etj.

- Krijimi i kushteve për kryerje të shërbimeve/punimeve të paparashikuara, si dhe shton zerat e punimeve të kërkuara më shumë, referuar kohës që kërkohet sipas manualeve të mirëmbajtjes etj.

(trajtuar më hollësisht në faqet 129-132 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

4. Rekomandim.

Për të shmangur pasojat e shkaktuara nga vonesat gjatë zhvillimit të procedurës së tenderit të "Mirëmbajtje e helikopterëve" lidhur me uljen e eficiencës, rritjen e shpenzimeve etj, autoriteti kontraktor të zhvillojë procedurën e tenderit "Marrëveshje kuadër", një herë në katër vjet, mbështetur në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Autoriteti kontraktor të jetë njësia shpenzuese, në cilësinë e pronarit, njëkohësisht përdoruesit, pasi kjo do të bëjë të mundur eliminimin e vonesave dhe kohëzgjatjen e lidhjes së kontratave, përcaktimin e saktë dhe në minimum të kohës, të nevojave dhe specifikimeve teknike për vendosjen në gatishmëri teknike të helikopterëve, eliminimin e zërave të punimeve shtesë, blerjen më shpejt të pjesëve të këmbimit të duhura për punime të paparashikuara dhe të paparashikuara etj.

Nën këtë arsyetim, lidhja e një kontrate shumëvjeçare do të lehtësonte/shkurtonte afatin e kryerjes së procedurave, kohën e realizimit të shërbimit të mirëmbajtjes, eliminonte zhvillimin e

procedurave tenderuese shitesë, për shkak të punimeve të paparashikuara dhe njëkohësisht do të zgjonte interesin e kompanive prestigjioze për t'u ofruar.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

5. Gjetje. Objekti i "*Rikonstruksion i objektit dykatësh, ish biblioteka e KDS-së me destinacion Qendër e Ekselencës*", me vlerë 45,400,279 lekë pa TVSH, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3929/3 datë 14.12.2017, të lidhur midis AK, dhe operatorit ekonomik "I.". Nga korrespondencat e palëve, konstatohet se gjatë procesit të punimeve të shtresave, prishjeve të suvatimit në mure brenda dhe jashtë, *ka çarje në strukturat mbajtëse*. Çarjet janë të dukshme me sy të lirë edhe në strukturat vertikale (muret mbajtëse) deri në themel dhe në strukturat horizontale (soleta b/a). Çarjet në muret mbajtëse në katin përdhe, vërehen jo vetëm në mur por edhe në brezat e betonit dhe shkalla e amortizimit të blloqeve të betonit vërehen me sy të lirë. Me procesverbalin e datës 09.02.2018, me pjesëmarrës të IGJIU u organizua një kontroll për verifikimin në vend të situatës. Me qëllim arritjen e një gjykimi të saktë tekniko profesional për zgjidhjen e problemeve, IGJIU ftoj si pjesëtare Profesorë të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm i Institutit të Ndërtimit. Nga konstatimi në procesverbal konstatohet se ekziston çarje vertikale të mureve në disa vende, ulje të soletës, çarje të soletës sipas drejtimit mbajtës dhe është një sallë me dimensione 7x17m të palidhur me mure tërthorë. Si përfundim bazuar problematikave, grupi i inspektimit ka gjykuar të bëhen sondazhe në themel, prova të markave të betonit, prova e soletës dhe prova në strukturën e tokës. Gjatë kohës së këtyre sondazheve në objekt, Investitori së bashku me mbikëqyrësin e punimeve, i ka kërkuar sipërmarrësit pezullimin e punimeve, me qëllim plotësimin e projektit me detaje të përforcimeve të nevojshme të strukturës, që do të kërkojnë zgjidhjen bazuar sondazheve. Me shkresën e Komandantit të nr. 486/4, datë 14.02.2018, drejtuar mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve kërkon pezullimin e punimeve të kontratës së "*Rikonstruksion i objektit dykatësh, ish biblioteka e KDS-së me destinacion Qendër e Ekselencës*". Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në periudhën e auditimit, nuk është marrë asnjë masë për realizimin e provave, testeve dhe sondazheve për realizimin e një relacioni teknik nga IGJIU, në mënyrë që të përfundojë kontrata sa më parë (*trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

5. Rekomandim

MM dhe Instituti Gjeografik Infrastrukturës Ushtarake të marrin masa, të analizojë dhe të hartojë një relacion teknik Ekonomiko-Konstruktiv mbi objektin e "*Rikonstruksionit të ish biblioteka e KDS-së me destinacion Qendër e Ekselencës*", duke arritur në përfundimin sa më parë të godinës dhe vënien në shfrytëzim të saj.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

6. Gjetje. Nga auditimi i pasqyrës financiare të Komandës së Forcave të Armatosura, si dhe nga verifikimi në terren nga grupi i auditimit në Bazën Ajrore, Farkë, u konstatua se është bërë ndërtimi i veprës me objekt "Ndërtim Hangar Mirëmbajtje për Helikopterët" në vlerën 70,025,172 me TVSH, ku është likuiduar subjekti për vlerën **67,897,522 lekë me TVSH**, i cili nuk është marrë ende në dorëzim. Hangari deri në momentin e auditimit në terren nuk përdorej madje kishte pësuar dhe dëmtime nga kushtet atmosferike nga erërat e forta ishte dëmtuar mbulesa e sipërme dhe vetrata anësore e hangarit, ku si rezultat i kësaj gjendjeje të gjithë helikopterët që ishin planifikuar për t'u strehuar momentalisht brenda këtij hangari janë alokuar në ambientet e jashtme të bazës, pavarësisht së nga baza ishin marrë masa për sigurinë fizike të tyre. Ambienti i jashtë për helikopterët, ndikon negativisht në pjesët e tyre fizike. Kontrata dhe projekti është i papërfunduar, ku zërat janë ngelur pa realizuar dhe punimet që kërkohen për përfundimin e objektit janë: *punime për instalimin e sistemit të ajrit të komprimuar së bashku me furnizimin dhe montimin e pajisjeve; punime për instalimin e sistemeve hidrosanitare dhe montimin e pajisjeve; punime për instalimin e pajisjeve të hapjes e të mbylljes së dyerve; punimet për instalimin dhe vendosjen e sistemit elektrik;*

punime për lyerjen e hangarit me bojë si dhe të dyerve(trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

6.Rekomandim:

Ministria e Mbrojtjes të marri masat që të planifikojë buxhet shtesë për përfundimin e veprës e cila nuk është funksionale dhe i ka kushtuar buxhetit të shtetit deri tani në shumën 67,897,522 lekë me TVSH.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

7. Gjetje. Në “Objektin dhe sipërfaqe funksionale të Repartit Ushtarak nr.3362 (Ish Komanda e vjetër e Bazës Ajrore, Kuçovë)”, me përfitues “B.”, në procesverbalin e mbajtur më datë 12.12.2017, nga Komisioni për monitorimin e kontratës deri në momentin e auditimit në terren nuk ishte kryer asnjë investim nga shoqëria, sipas kontratës së lidhur, me pretendimin që Bashkia Ura Vajgurore nuk e ka pajisur me leje zhvillimi dhe leje ndërtimi. Shoqëria më datën 04.08.2017 (një vit pas nënshkrimit të kontratës) i është drejtuar me shkresë Bashkisë, ku i kërkon përsheptimin e procedurave për të aplikuar për lejen e zhvillimit dhe lejen e ndërtimit. Nga MM ndaj subjektit në proceset e monitorimit nuk është marrë asnjë masë, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, ku një ndër kushtet e kontratës është se në rastin kur Qiramarrësi në përfundim të çdo faze nuk ka realizuar nivelin e punësimit gjatë në masën 50.000 lekë, për çdo vend pune të pahapur. Pra Qiramarrësi në përfundim të vitit 2017 duhej të kishte të punësuar 20 punonjës. Gjithashtu duhet theksuar se afati i përfundimit të investimit është Dhjetor 2018, nga ku subjekti ka afat për të realizuar një shërbim miliona lekë për 6 muaj (*trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

7. Rekomandimi:

MM në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë të marrin masa për shkëputjen e kontratës me subjektin “B”, për mosplotësim të pikave të kontratës në lidhje me investimin, si dhe të penalizojë subjektin sipas masave të parashikuara në kontratë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

8. Gjetje; Në objektin “Pesë tunele dhe sipërfaqe funksionale”, në administrim të Brigadës Logjistike, Reparti nr. 4001 e ndodhur në Babrru, Paskuqan me sipërfaqe të përgjithshme 1478.63m², me përfitues “E.H.F.”, e cila ka paraqitur një raport për periudhën 2016-2017, ku thekson se realizimi i investimeve të kryera është realizuar dhe tejkaluar. Grupi i monitorimit me datën 04.01.2018 shprehet se, subjekti ka të pa paguar detyrimin e qerasë për një periudhë 4-mujore bashkë me kamat vonesat, si dhe nuk ka sjellë informacionin vjetor për realizimin e planit të biznesit sipas kontratës, informacion i cili i është dërguar dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 34, datë 04.01.2018. Ndaj subjektit nuk është marrë asnjë masë administrative, për mosplotësimin të kushteve të kontratës(*trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

8.Rekomandimi:

MM në bashkëpunim me ministrinë e Financës dhe Ekonomisë të marrin masa për shkëputjen e kontratës me subjektin “E.H.F”, në zbatim të Kodit Civil, neni 698, neni 702 dhe kushteve të kontratës nr. 2545, datë 03.05.2016, si dhe të penalizojë subjektin sipas masave të parashikuara në kontratë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

9. Gjetje. Dosja e teknike të zbatimit me objekt “Shtesë Depo Karburanti Jet A1 në Bazën Ajrore Farkë”, me vlerë 29,264,241 lekë pa TVSH, është kryer sipas kontratës të lidhur midis Komandës së Forcës Ajrore dhe operatorit ekonomik “B.I.”. Zbatimi i kontratës ka pasur disa problematika lidhur preventivin e punimeve, në të cilën është kërkuar fond shtesë për depon e karburantit Jet A1 në Bazën Ajrore Farkë. Me shkresën e Institutit Gjeografik dhe Infrastrukturës Ushtarake, i kthehet

përgjigje Komandës së Forcës Ajrore, duke miratuar shtesën e kontratës dhe duke hartuar preventivin e shtesës së kontratës në vlerën prej 3,465,000 lekë, me TVSH. Nga verifikimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar të kontratës fillestare dhe kontratës shtesë, u konstatua pasaktësi, në zërat e ndryshimeve të aksesorëve, pasi situacionit të shtesës së kontratës, ku u miratuan dhe u likuiduan ndryshimet për aksesorët, në të cilën përfshihen gomina, kapakë, valvula, bryla, T-i, adaptorë, manikota, filtra, bulona, dado, niples etj, përbëjnë aksesorët komplet të depove të karburantit. Rrjedhimisht në kapitullin B të punimeve mekanike, zërat nr. 11, nr. 12 "F.V aksesorë e linjës së furnizimit (ngarkimit)" dhe "F.V aksesorët e linjës së shpërndarjes (thithjes)", të likuiduara në situacionin përfundimtar të kontratës fillestare, përbëjnë zëra pune të dubluara dhe të përfituara padrejtësisht nga sipërmarrësi, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 213,120 lekë.**

-Ndryshimet e projekt-preventivit të kontratës, duke rritur vlerën e kontratës për shkak të ndryshimeve të specifikimeve dhe parametrave teknike, përbën tjetërsim të procedurës tenderuese. Vlera e shtesës së kontratës prej 3,465,000 lekë me TVSH, përbën përdorim jo me ekonomikitet, eficensë dhe efektivitet të fondeve publike, pasi është shmangur procedura e hapur e tenderimit, nga ndryshimet e specifikimeve teknike.

(trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

9. Rekomandim:

Nga Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti Gjeografik Infrastrukturës Ushtarake, në rastet e tjera në vazhdim për projektet e rikonstruksioneve mekanike apo ndërtime, të rishikohen me kushtet e Standardeve Ndërkombëtare, në mënyrë që të rritet performanca dhe rendimenti i pajisjeve mekanike.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

10. Gjetje: Nga auditimi në terren në Bazën Detare në Pashaliman dhe informacionit të marrë u konstatua se për anijen (Dragamina) e mbytur e të ankostuar në bankinën e bazës së Pashalimanit janë bërë dy procedura prokurimi "Nxjerrje anije nga uji" të cilat janë anuluar. Në procedurën e parë operatori ekonomik fitues, pasi është shpallur fitues dhe është thirrur për të lidhur kontratën, nuk është paraqitur me pretendimin se kalimi i mjeteve të tonazheve të rënda në urën e cila ndodhet brenda Garnizonit të Pashalimanit është e pamundur, pretendime për arsye teknike të cilat nuk janë të përcaktuara në dokumentet e procedurës.

Ndaj subjektit nuk është marrë asnjë masë për faktin se nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar sigurimi i ofertës. Pas anulimit të procedurës së parë të prokurimit, u realizua procedura e dytë po me kërkesën e Komandës së Forcës Detare drejtuar në Ministrinë e Mbrojtjes, e cila u anulua për faktin se nuk u paraqit asnjë operator ekonomik.

MM që nga viti 2016 e deri në momentin e auditimit në terren nuk ka zhvilluar procedurë tjetër prokurimi, pavarësisht nga kërkesat e vazhdueshme nga Komanda e Forcës Detare, për realizimin e prokurimit për të mundësuar nxjerrjen anijes nga uji, pasi është e akustuar në breg, duke penguar ankorimin e anijeve të tjera. Nga verifikimi në terren nga grupi i auditimit u konstatua se anija ishte fundosur dhe nëse vazhdonte të lihej në atë gjendje nxjerrja e saj do bëhet edhe me e vështire dhe do të ketë kosto të lartë financiare*(trajtuar më hollësisht në faqet 44-66 të Raportit Përfundimtar të auditimit)*.

10. Rekomandimi:

MM të marra masa të menjëhershme për realizimin e procedurës së prokurimit "Nxjerrje anije nga uji" dhe operatorëve ekonomik i cili pas shpalljes së njoftimit fitues, nuk paraqitet për të lidhur kontratën ti kërkohet APP-së përjashtimin e këtij operatori nga marrja e pjesë në prokurime për një afat të paracaktuar.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

11. Gjetje: Nga auditimi në terren në Bazën Detare në Pashaliman dhe informacionit të marrë mbi gjendjen e anijeve në portet detare u konstatua se nga 46 mjete lundruese gjendje , 38 prej tyre janë

jashtë përdorimi dhe 16 gjendje gatishmërie të ankoruara në portet e Pashaliman, Durrës, Bishpall, Rroguzë, Shëngjin. Nga 38 anijet të dala jashtë përdorimi, për 25 anije është bërë kategorizimi nga Komisioni i Posaçëm i Kategorizimit, për kalimin e tyre në muze, skrap si dhe për shitje për përdorim jo ushtarak, ndërsa për 13 anije të tjera nga KPK nuk është marrë asnjë masa për kategorizimin e tyre edhe pas propozimeve të herë pas hershme nga Baza e Pashalimianit në MM. Gjithashtu u konstatua se dhe anijet të cilat janë kategorizuara për muze nuk plotësonin kushtet për muze dhe për to është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme KPK që të bëhet ri-kategorizimi i tyre pasi ato janë të mbytura në vendet të cilat janë të akostuara. Për disa të cilat janë kategorizuar muze realisht nuk ekzistojnë fizikisht, pasi janë shitur si skrap, dhe KPK i ka kategorizuar gabimisht në anije muze (*trajtuar më hollësisht në faqet 44-66 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

11. Rekomandimi:

Komisioni i Posaçëm i Kategorizimit në MM të marrë masat për të vlerësuar gjendjen e anijeve dhe të bëjë kategorizimin dhe ri-kategorizimin e tyre, pasi zgjatja në kohë e procedurave rrit koston financiare në dëm të buxhetit të shtetit.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

12. Gjetje: Nga auditimi në terren në Bazën Detare në Pashaliman u konstatua se, pajisjet e vlerësuara për jashtë përdorimi të cilat mbahen tek parku i transportit nuk është marrë asnjë masë për shitjen e tyre si skrap ose për vazhdimin e procedurave të shkatërrimit sipas udhëzimit MM nr. 3 datë 13.03.2015/” Për trajtimin e tyre pas heqjes nga përdorimi” (*trajtuar më hollësisht në faqet 44-66 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

12. Rekomandimi:

MM të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për të realizuar procesin e shkatërrimit të këtyre aktiveve dhe nxjerrjen në ankand për shitje si skrap.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

13. Gjetje: U konstatua se, llogaria 215 “Mjete Transporti” nga viti 2015 është rritur me vlerën 1,872,725,138 lekë, ku u vërejt se ndikim të konsiderueshëm ka pasur kalimi në pronësi të Komandës së Forcave të Armatosura i helikopterëve nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore në vlerën 984,381,560 lekë dhe helikopterët nga RENEA në vlerën 630,524,435 lekë, në zbatim të VKM-së nr. 964 datë 02.12.2015 “ Për kalimin e helikopterëve dhe të pajisjeve të tyre, nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Mbrojtjes”. Nga shtatë helikopterët të marrë në dorëzim nga MSH, tre nga helikopterët ishin në gatishmëri për fluturim, ndërsa katër të tjerët ishin jashtë gatishmërisë për fluturim. Ndërsa nga pesë helikopterët të marrë në dorëzim nga MB, dy nga helikopterët ishin në gatishmëri për fluturim, ndërsa tre të tjerët ishin jashtë gatishmërisë për fluturim. Me marrjen në dorëzim të këtyre helikopterëve, Top-i i Bazës Ajrore ka në pronësi 25 helikopterë. Baza Ajrore Farkë në prill të vitit 2016 ka filluar procedurat për mirëmbajtjen e helikopterëve të marrë nga MSH dhe MB, duke hartuar kërkesat operacionale për mirëmbajtje dhe vënien në funksion për çdo tip helikopteri, të cilat janë dërguar në Komandën e Forcës Ajrore. Mbështetur në kërkesat e dërguara në KFA janë miratuar kërkesat për riparimin e dy helikopterëve në muajin Nëntor –Dhjetor 2016, një i tipit MI-8 me shenjë ZA-MFE i policisë dhe EC-135 me shenjë ZA-ZHB i shëndetësisë. Përsëri në vitin 2017, nga Baza Ajrore Farkë janë dërguar kërkesat operacionale për riparim mirëmbajtje të helikopterëve në Komandën e Forcës Ajrore, nga të cilët është marrë në konsideratë dhe është riparuar helikopteri ALO-3/SA-319 me shenjë ZA-ZHP i shëndetësisë. Nga verifikimi në bazë dhe nga te dhëna e disponueshme nga baza ajrore rezulton se, në gatishmëri për fluturim për të përballuar situatat emergjente janë vetëm dy helikopterë të shëndetësisë për emergjencat shëndetësore, ndërsa helikopterët e tjerë të kaluar në pronësi të bazës Ajrore nuk janë në gjendje gatishmëria për fluturim, megjithëse lidhja e kontratave për riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre deri në momentin e auditimit në terren ishte në proces.

Për sa më lartë del qartë se kërkesat e dërguara për riparimin e helikopterëve nuk janë marrë në konsideratë për mirëmbajtje e tyre nga MM, për vënien në funksion për realizimin e objektit në rastet e emergjencave dhe krizave civile (*trajtuar më hollësisht në faqet 44-66 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

13. Rekomandimi:

Ministria e Mbrojtjes, të marrin masat, që të shqyrtojë të gjitha kërkesat dhe të planifikojë buxhet të mjaftueshëm për riparimin dhe mirëmbajtje e helikopterëve, me qëllim vënien në funksion për realizimin e objektit në rastet e emergjencave dhe krizave civile. Mos riparimi në kohë i tyre dhe mospërdorimi çon në rritjen e kostove të mirëmbajtjes dhe moseficencë të përdorimit të fondeve buxhetore në kohë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

14. Gjetje: Nga verifikimi në terren i grupit të auditimit të realizuar në bazën ajrore në Farkë u konstatua se nga 25 helikopter të regjistruara në asete të Top-i i Bazës Ajrore, në gjendje gatishmërie për fluturim ishin pesë. Të gjithë helikopterët e tjerë kërkonin punime mbi 1-vit, ku për 13 prej tyre nuk ishte planifikuar buxhet që nga viti 2014, ndërsa për pjesën tjetër ishin në provë vlerësimi, duke shkaktuar situatë jo të favorshme për gatishmërinë ushtarake dhe civile (*trajtuar më hollësisht në faqet 44-66 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

14.Rekomandimi:

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të marrë masa për ngritjen e grupit të punës që të bëjë vlerësim e gjendjes aktuale të këtyre helikopterëve duke i ndarë në kategori ato që janë për riparim dhe ato që janë për dalje jashtë përdorimi. Mbas procesit të vlerësimit të marri masat për të vazhduar procedurat e mëtejshme nëse duhet shkatërruar, shitur për skrap apo të kalojnë si mjete muzeale në ambiente të përcaktuara nga MM.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

15. Gjetja: Nga auditimi s pasqyrave financiare përmbledhëse për të gjithë njësi vartëse, në fund të vitit 2017, gjendja debitorë (klasa 4) paraqitet në vlerën 2,563,767,199 lekë, nga e cila një pjesë e konsiderueshme paraqiten pa shpresë arkëtimi, sepse është krijuar dhe e trashëguar nga dëmet e vitit 1997. Për Aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes, vlerë e konsiderueshme mbetet mos rakordimi i shumës 16,772,727 lekë, e cilësuar në pasqyrën e vitit 2015 e në vazhdim, me debitor Ministria e Jashtme. Ky detyrim është krijuar para vitit 2007, për shkak se të gjithë shpenzimet që bëheshin për Atashet dhe Përfaqësuesit Ushtarak kalonin nëpërmjet llogarive të ambasadave me ndërmjetësim të Ministrisë së Jashtme. Për këtë shumë nuk është bërë asnjë rakordim midis dy institucioneve për të gjetur zgjidhjen e mbylljes së kësaj vlere (*trajtuar më hollësisht në faqet 44-66. të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

15. Rekomandimi:

MM të marri masa, duke krijuar grup pune të veçantë me përfaqësues të fushës së financave dhe fushës juridike për analizimin e hollësishtëm të detyrimit dhe ti propozohet Ministrisë së Financave që kjo shumë të mbahet në llogaritë jashtë bilancit. Gjithashtu të analizohet dhe të bashkëpunohet me Ministrinë e Jashtme, për gjetjen e një zgjidhje në lidhje me mbylljen e shumës prej 16,772,727 lekë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

16. Gjetje: Në Ministrinë e Mbrojtjes ka vende vakante për të cilën është kërkuar pranë DAP hapja e konkurimit për plotësimin e tyre. Nga Ministria dhe nga DAP nuk është marrë asnjë masë që punonjësit në listë pritje dhe që vazhdojnë të paguhen nga buxheti i shtetit të bëhet sistemimi i tyre në këto vende vakante, po kërkohet të plotësohen me staf të ri, ndërkohë për një pozicion pune janë paguhur dy persona, i punësuar aktual dhe personi që është në listë pritje apo që ka fituar gjygin për tu rikthyer në atë pozicion ose ekuivalente me pozicionet e mëparshëm, duke rënduar kështu

padrejtësisht buxhetin e shtetit ku vetëm për një për një vit nga ky veprim, kosto buxhetore është rritur rreth 13,651,200 lekë.

(trajtuar më hollësisht në faqet 19-26 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

16.Rekomandim:

Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me DAP të marrin masat, që për vendet vakante prioritet tu jepet punësimi i punonjësve në listë pritje, me qëllim eliminimin e pagesave të dyfishta për një pozicion pune.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

17. Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me mbylljen e shpenzimeve të AU&PU të rakorduara me sektorin e financës u konstatua se, mbyllja e shpenzimeve bëhet sipas rastit ose ardhjes me pushime të AU&PU në Shqipëri, pa i nënshtruar asnjë lloj rregulli apo kriteri. Në disa raste një pjesë e AU & PU i mbyllnin shpenzimet për 6 muaj, një pjesë tjetër kishte edhe 2.5 deri në 3 vjet, që s'kishin ardhur për të bërë mbylljet e aktivitetit financiar, siç ishin PU Stambolli dhe PU Francë *(trajtuar më hollësisht në faqet 19-26 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

17. Rekomandim:

MM të marrë masat për të përcaktuar afatet për mbylljen e shpenzimeve financiare, e cila duhet të ketë një vijimësi duke përcaktuar periudhat se kur duhet bërë mbyllja e shpenzimeve. Nuk duhet caktuar periudha Korrik – Gusht ose Dhjetor, pasi kostoja e udhëtimit për ardhjen e atasheve dhe përfaqësuesve për mbylljen e shpenzimeve bëhet nga buxheti i shtetit dhe çmimi i biletave për këto periudha janë shumë të larta.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

18. Gjetje: Buxheti i shtetit për mbulimin e veprimtarisë së Atasheve Ushtarake të akredituara në vendet e tjera që shërbejnë në Përfaqësitë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë, për të tre vitet 2015,2016 dhe 2017 ka financuar në total 776,116 mijë lekë. Pjesa më e madhe e këtij fondi është përdorur për pagesat e apartamenteve dhe pajisjeve shtëpiake të marra me qira e cila për të tre vitet llogariten në vlerën 425,172 mijë lekë. Nga auditimi mbi ligjshmërinë e përdorimit të këtyre shpenzimeve u konstatuan, shkelje dhe parregullsi që lidhen kryesisht me pagesat e qirasë së apartamenteve dhe qirasë së pajisjeve shtëpiake,

I gjithë procesi i marrjes me qira dhe lidhja e kontratave të qiramarrjes për apartamentet e të përfaqësive dhe Atasheve ushtarake është bërë në kundërshtim me, ligjin e prokurimit për blerjet me vlerë të vogël dhe Udhëzimin nr. 6, datë 02.05.2014, “Për disiplinimin e fondeve buxhetore në funksion të veprimtarisë së Atasheve & Përfaqësuesve Ushtarake” pika f/viii sepse:

- Nuk është bërë studimi i tregut në lidhje me vlerën e qerasë së apartamenteve, për të përcaktuar një limit për qiranë e apartamenti të çdo përfaqësie, por vlera e qirasë është përcaktuar në bazë të tre oferta të marra nga vetë qiramarrësit dhe më pas i paraqitën Ministrisë për miratim.

- Nuk është ngritur komision i vlerësimit të ofertave, por vlerësimi i tyre është bërë vetëm nga përgjegjësi i shërbimeve në Ministri. Të gjitha ofertat e marra nuk kanë të bashkëlidhur, planimetrinë (gen-planet) e apartamenteve që do të merren me qira në bazë të të cilave përcaktohen edhe sipërfaqet e apartamentit.

-Ofertat e paraqitura në të shumtën e rasteve janë foto të printuara nga interneti të marra nga agjencitë imobiliare, ku çmimet e tyre varrojnë në nivele të larta, pasi apartamentet që merren si ofertë kanë sipërfaqe të mëdha ku shkojnë deri në mbi 180 m2.

- Pas përzgjedhjes së ofertës nga përgjegjësi i shërbimeve dhe miratimi i saj nga Sekretari i Përgjithshëm, përfaqësuesit ose atasheet ushtarake kanë bërë lidhjen e kontratave të qirasë. Por këto kontrata lidhura mes palëve në asnjë rast nuk janë të regjistruara pranë Zyrës së Tatim Taksave, të noterizuar dhe nuk kanë asnjë dokument justifikues për të përcaktuar qartë adresën ku ndodhet ndërtesa, sipërfaqja në metër katror etj.

(trajtuar më hollësisht në faqet 19-26 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

18.Rekomandim:

Ministria e Mbrojtjes të marrë masa që, për çdo rast të marrjes së apartamenteve me qira, të ngrihet grup pune i veçantë për të bërë vlerësimin e tregut të çmimeve të qirave të apartamenteve, bazuar në zonat ku preferohet të merret apartamenti, normativat e sipërfaqeve për çdo familjar, mobilimin apo jo i apartamenteve dhe përcaktimin e çmimit brenda një limiti të caktuar për m² të qirasë sipas çmimeve të tregut të vendit të huaj, dhe nëse është e mundur çmimi për m² të justifikohet me dokumente zyrtare të vendit ku merret apartamenti (referencat ligjore të tatimeve apo akte ligjore e nënligjore që përcaktojnë dysHEME dhe tavane të apartamenteve të marra me qira).

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

19. Gjetje: Ministria e Mbrojtjes duke qene se në fillim të vitit bën parashikimin e evevente me matricën, pothuajse në të gjitha rastet gjate vitit 2015, 2016 shpenzime pritje përcjellë, shpenzimet për kancelari dhe printime për organizime eventesh të ndryshme si, trajnime e konferenca, Eëorkshope, shpenzime për qera salle, etj., blerjet janë realizuar mbështetur në programet të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm mbi aktivitetin që do të zhvillohet ose mbështetur në një urdhër të lëshuar nga Ministri, pa realizuar procesin e prokurimit on-line, duke rriskuar përdorimi me efektivitet dhe me ekonomicitet të fondeve publike

Në të gjitha këto raste blerja e shërbimeve është bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" dhe Udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015,"Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", sepse për këtë shërbim nuk janë kryer procedura prokurimi (trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

19.Rekomandimi:

Për të gjitha rastet e marrjes së shërbimit për nevojat e MM, të kontraktohen sipas rregullave te prokurimit publik, për përzgjedhjen e ofertës më të mirë në favor të përdorimit efektiv të fondeve të buxheti

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

20. Gjetje: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se në urdhër shpenzimin nr. 965 datë 20.12.2016 është likuiduar subjekti A. në shumën 3,582,051.6 lekë, për shërbime mirëmbajtje të sistemit të kondicionimit, sipas faturave numër 120, datë 01.12.2016 në vlerën 2,425,815.6 lekë dhe në faturën nr. 127, datë 16.12.2016 në vlerën 1,156,236 lekë. faturat kishin të bashkëlidhur situacionin e punimeve të realizuara nga firma, disa akt-konstatime të mbajtura për punimet e realizuar për shërbimin e kondicionimit nëpër zyra, ndërsa për marrjen në dorëzim të punimeve të tjera të realizuara në institucion është firmosur nga një person i vetëm znj. M. R, e cila ka qenë kryetare e komisionit të blerjeve të vogla. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" ku ne pikën e 42 citon se "Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen ne dorëzim te aktiveve te furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe te dokumentacionit shoqërues si dhe në pikën 43 ku citohet se "Komisioni përbëhet nga specialistë te fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale (trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

20.Rekomandim:

Ministria e Mbrojtjes të marrë masa që për të gjitha shërbimet apo punimet e realizuar në institucion, në përfundim të tyre të merren në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim, të cilët duhet të jene specialist të fushës. Të gjitha veprimet duhet të jenë të dokumentuara me dokumente justifikuese.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

21. Gjetje: Nga auditimi i veprimeve me arkë u konstatua se në mandat pagesën nr. 402, datë 28.10.2016 është paguar znj. M. L., me përfitues Ministria e Punëve të Jashtme në shumën 5,350 euro, mbështetur në shkresën e Ministrisë së Jashtme nr. 10955, datë 22.09.2016 “Kërkesë për shlyerje detyrimi”, ku kërkohet shlyerja e detyrimit të hotelit të delegacion të Ministrisë së Mbrojtjes në Varshavë të Polonisë paguar nga Ministria e Punëve të Jashtme. Kjo pagesë e realizuar cash nga institucioni është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 63 dhe 64 ku përcaktohet se “*Veprimet me para në dorë kryhen vetëm brenda limitit ditor të arkës të miratuar nga Nëpunësi i Parë Autorizues me propozim të Sistemit të Thesarit, me akte të veçanta sipas specifikave të të njëjve publike. Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë*” (trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

21.Rekomandim:

Ministria e Mbrojtjes të marrë masa që për shlyerjen e detyrimeve ndaj subjektev, institucioneve ose personave fizik që nuk janë në kategorinë paradhënies për udhëtime e dieta të kryhet me urdhër shpenzim nëpërmjet sistemit të thesarit.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vazhdim

22. Gjetje: Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve në MM në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të MM nuk ka përpiluar një raport përmbledhës mbi rezultatin e inventarëve duke krahasuar gjendjen kontabël me atë fizike të raportuar nga komisionet e inventarizimit

- Nga dokumentacioni i dorëzuar komisioni nuk ka bërë shënimet përkatëse ose vërejtje për produktet të cilat kanë propozuar për dalje jashtë përdorimi.

- Komisioni nuk ka përpiluar një raport për vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve.

- Komisioni i vlerësimit të daljes se aktiveve jashtë përdorimi nuk ka përpiluar një raport përmbledhës për këto aktive të propozuara nga komisioni i inventarizimit. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

22.Rekomandim:

- Komisioni inventarizimit për cdo fletë inventari të mbajtur gjatë procesit të inventarizimit të bëjë shënimet përkatëse përbri cdo aktiv mbi cilësinë e gjendjes fizike të tij, të përpilojë një rapor vlerësimi paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre dhe t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues.

- Komisionet e inventarizimit të Aktiveve në MM të marri masat që në fund të çdo procesi inventarizimi të përpilojë raportin përmbledhës të gjendjes së aktiveve dhe të bëjë krahasimin e të dhënave të aktiveve që rezultojnë gjendje sipas inventarizimit fizik me gjendjen kontabël të regjistruar nga sektori i financës mbi bazën e fletëhyrjeve dhe fletë daljeve.

- Komisioni i vlerësimit mbështetur në propozimet e bëra nga komisioni i inventarizimit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve, duhet të përpilojë relacionin e vlerësimit ku përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit të vlerësimit.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

23. Gjetje: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatu se në urdhër shpenzimin nr. 437, datë 19.06.2015 është likuiduar subjekti “2.P” shpk në shumën 759,510 lekë, për shpenzime mirëmbajtje dhe objekte specifike, e cila është realizuar si raste emergjent nga komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, me pretendimin se nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për realizimin e procedurës online të

këtij prokurimi, pasi njoftimi për lyerjen e godinës i është dërguar me datën 01.06.2015. Subjekti ka bërë lyerjen e një sipërfaqe prej 2910 m² me lartësi 6-10 m po me datën 01.06.2015, për të cilën Ministria është shprehur se vetë punonjësit e saj nuk e realizojnë dot pasi kërkon skela dhe numër të madh punonjësish. Nga auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit nuk rezulton asnjë dokument që të vërtetojë se

- rasti në fjalë është emergjent.

- nëse subjekti i cila ka realizuar shërbimin plotëson kriteret për të realizuar shërbimin në fjalë sipas specifikimeve dhe brenda një dite.

- dhe s'ka asnjë dokumentacion bashkëngjitur (foto) për të vërtetuar nëse ky shërbim është kryer kur është marrë në dorëzim nga grupi i marrjes në dorëzim.

(trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

23.Rekomandim:

Ministria e Mbrojtjes në vazhdimësi të marri masat që të gjithë blerjet që realizohen si raste emergjente, të argumentohen dhe të bashkëlidhet i gjithë dokumentacionin justifikuese, për të vërtetuar përdorimin efektiv të fondeve të buxheti

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

24. Gjetje: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatu se në urdhër shpenzimin nr. 82, datë 05.03.2015 është likuiduar subjekti “I.o” shpk në shumën 459,240 lekë, për blerje letre fotokopje A4 80gr/m² me faturën tatimore nr. 119813840 datë 23.02.2015, sipas shtesës së kontratës nr. 648 datë 17.02.2015, në zbatim të urdhrit të ministres nr. 285 datë 17.02.2015 me të cilën autorizon Drejtorinë e Administratës dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të shërbimeve mbështetëse, të lidhë kontratën shtesë për plotësimin e nevojave në fillim të vitit 2015. Por nga verifikimi i gjendjes së mallit në magazinë me datën 31.12.2014 rezulton të jetë gjendje 3,498 Risma në vlerën prej 1,070,947 lekë, pra gjysma e sasisë së prokuruar në zbatim të kontratës fillestare nr. 7379 datë 15.09.2014 me objekt “ Blerje Letër” në vlerën 2,296,199 dhe në sasi 7,500 risme, të cilat janë bërë hyrje në magazinë me datën 22.09.2014. Pra sasia e prokuruar me shtesën e kontratës nuk ka qene e nevojshme për nevojat e fillim viti pasi me gjendjen që disponon MM në magazinë përballoheshin nevojat deri në lidhjen e kontratës së re nr. 3760/2, datë 08.05.2015, mbi bazën e të cilës janë blerë 6800 Rismë të cilat janë bërë hyrje në magazinë me datën 20.05.2015. kjo ka ardhur si pasojë e mos verifikimit të gjendjes së mallit në magazinë nga Drejtoria Mbështetëse dhe mos planifikimi i nevojave nga njësitë shpenzuese për periudhën në fjalë *(trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit)*.

24.Rekomandim:

MM përpara se të lidhe shtesë kontrate të marri masat që të verifikojë gjendjen e mallit në magazine dhe të planifikojë nevojat e institucionit, në mënyre që fondet të menaxhohen me ekominicitet, eficence dhe efektivitet.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

25. Gjetje: Me urdhër shpenzimin nr. 878, datë 20.11.2015 është likuiduar subjekti “Pastrime Silvio” shpk në shumën 214,800 lekë, për dezinfektimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme. Komisioni i prokurimit për blerjen e vogla ka bërë blerje ne kushte emergjente, ku procesverbali është mbajtur me datën 19.09.2015. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur kësaj procedure konstatohet se mungojnë procesverbal nga ekspertë të cilët duhet të vërtetojnë situatën emergjente, urdhër i miratuar nga Ministri ose Sekretari i Përgjithshme për realizimin e kësaj procedure si dhe procesverbali i realizimit të shërbimit *(trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit)*.

25. Rekomandimi:

Ministria e Mbrojtjes të marri masat që të gjithë blerjet që realizohen si raste emergjente, të argumentohen dhe të bashkëlidhet i gjithë dokumentacionin justifikuese, për të vërtetuar përdorimin efektiv të fondeve të buxheti.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

26. Gjetje: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se në urdhër shpenzimin nr. 1019, datë 16.12.2015 është likuiduar subjekti "F." shpk në shumën 120,000 lekë, për prodhimin e 20 posterave adeziv. Me urdhër shpenzimin nr. 217, datë 12.04.2016 është likuiduar subjekti "Flesh" shpk në shumën 115,200 lekë, për prodhimin e 20 flamujve dhe të një mokedi një përdorimesh bashke me vendosjen.

Përzgjedhja e operatorit nga komisioni i blerjeve të vogla për realizimin e shërbimit nuk i është nënshtruar procedurave të prokurimit on-line veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe Udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015, "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", ku shërbimi i realizuar dhe i paguar përbën përdorim jo efektiv të fondeve buxhetore (*trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

26. Rekomandim:

Ministria e Mbrojtjes të marra masat që në rastet e blerjes së mallrave, shërbimeve dhe punë nga operatorë ekonomik të zhvillohet procedura e prokurimit online, duke bërë të mundur përzgjedhjen e ofertës më të mire dhe më efektive, me ndikim pozitiv në buxhetin e shtetit.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

27. Gjetje: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se në urdhër shpenzimin nr. 244, datë 22.04.2016 është likuiduar subjekti "Flesh" në shumën 953,880 lekë, Komisioni i blerjeve të vogla ka realizuar procedurën për prokurim me datën 23.03.2015, ku është bërë studimin i tregut në lidhje me çmimet për të përcaktuar fondin limit në shumën prej 977,000 lekë me TVSH. Kjo procedurë është anuluar me arsyetimin se asnjë nga 5 operatorët e parë nuk përmbushte kërkesat e vendosura në ftesën për ofertë. Komisioni pas kësaj ka realizuar procedurën në rast emergjent, ku është realizuar shërbimi me subjektin "F.", i cili ishte renditur i parafundit në rastin e prokurimit të realizuar me ofertën më të lartë nga 19 operatorë. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe Udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015, "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla" ku në pikën 5 citohet se "Në rastin kur, autoriteti kontraktor ka shpallur dy herë radhazi në sistemin elektronik të prokurimit procedurën me vlerë të vogël dhe kjo procedurë prokurimi është anuluar për shkak të mungesës së konkurrencës, atëherë autoriteti mund të vijojë me realizimin e procedurës në rrugë shkresore sipas procesverbalit nr.6".si dhe udhëzim nr. 1, datë 21.04.2016, procedurë e cila nuk është realizuar nga komisioni (*trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

27.Rekomandim:

Komisioni i blerjeve të vogla në Ministrinë e Mbrojtjes të marrë masat që në vazhdimësi të ndiqen të gjitha procedurat e prokurimit të përcaktuar në ligjin për prokurimin publik, të bëjë vlerësimin e ofertave dhe të sigurojë kushtet për trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në mënyrë që të sigurojë përdorimin sa më efektiv të fondeve publike.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

28. Gjetje: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se për periudhën 2015,2016 dhe 2017, çmimi i biletës për itinerare të ndryshme ishte shumë i lartë krahasuar me çmimet e tregut të periudhës, ku marzhi i fitimit për shoqërinë arrinte në vlera shumë të larta, çka tregon përdorimin joefektiv të fondeve buxhetore. Në një pjesë të konsiderueshme të realizimit të prokurimit fondi limit është llogaritur bazuar në një ofertë, çka tregon se nuk është bërë studimi i tregut, për të vlerësuar ofertat në favor të përdorimit efektiv të fondeve buxhetore. Komisioni i blerjeve të vogla

ka bërë blerje emergjente të biletave, edhe pse ka pasur kohë të mjaftueshme për të realizuar procesin e prokurimit online, nga dalja e urdhrimit deri në momentin që do realizohej shërbimi i udhëtimit. Gjithashtu u konstatua se komisioni i prokurimit për blerjen e biletave ka bërë prokurimin për bileta në të njëjtën ditë dhe për të njëjtin Itenerar, ku çmimi i biletave është i ndryshëm dhe me diferenca të konsiderueshme, çka tregon mos vëmendje të komisionit që nuk ka bërë vlerësimin e ofertave dhe krahasimin me çmimet e tregut të periudhës.

Një pjesë e problemit të konstatuara më sipër nga grupi i auditimit janë rregulluar më udhëzimin nr. 10, datë 30.05 .2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 09.01.2018 “mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”. (trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

28.Rekomandim:

Sektori i shërbimeve mbështetëse në MM në vazhdimësi të marri masat që në “Ftesën për Ofertë” të mos përcaktoj fondin limit, me qëllim që operatorët ekonomikë të ofertojnë bazuar në të dhënat teknike sasiore që përcaktohen në ofertë, në zbatim të udhëzimit nr. 10, datë 30.05 .2018 “për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

29. Gjetje: Nga auditimi i veprimeve të arkës u konstatua se në mandat pagesën nr. 430 datë 17.11.2016 është paguar z. I.P si administrator në përfaqësinë ushtarake kombëtare në ACO/Shape MONS Belgjikë, në shumën 170 euro, për rinovim pasaporte të dy fëmijëve të tij, me arsyetimin se pasaportat e lëshuara në 2009 dilnin të pavlera sipas njoftimit të dhënë nga Ministria e Jashtme. . Pagesa e realizuar nga Drejtoria e Financës është bërë mbështetur në kërkesën e z. I.P dhe në Memon nr. 6519/1 datë 15.11.2016 ku nëpunësi autorizues (NA) ka dhënë miratimin e tij për rimbursimin e shpenzimit, të pa mbështetur në bazë ligjore, si dhe në kundërshtim me VKM-në nr. 305, datë 12.03.2008 “Për përballim shpenzimesh të Atasheve Ushtarak të Forcave të Armatosura që shërbejnë në Shtabet e NATO-s e në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s dhe të ushtarakeve shqiptare që shërbejnë pranë organizatave ndërkombëtare dhe në shtabet Ushtarake Ndërkombëtare” i ndryshuar, udhëzimin MM me nr. 6 datë 02.02.2014 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore në funksion të veprimtarisë së atasheve dhe përfaqësuesve ushtarak” (trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

29.Rekomandim:

Drejtoria e Financës në Ministrinë e Mbrojtjes të ndjekë të gjithë procedurat administrative dhe ligjore për kthimin në Buxhetin e Shtetit të vlerës prej 170 euro, nga z. I.P të përfituar padrejhtësisht dhe të pabazuar në ligj.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

30. Gjetje: Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve në MM në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të MM nuk ka përpiluar një raport përmbledhës mbi rezultatin e inventarëve duke krahasuar gjendjen kontabël me atë fizike të raportuar nga komisionet e inventarizimit

- Nga dokumentacioni i dorëzuar komisioni nuk ka bërë shënimet përkatëse ose vërejtje për produktet të cilat kanë propozuar për dalje jashtë përdorimi.

- Komisioni nuk ka përpiluar një raport për vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve.

- Komisioni i vlerësimit të daljes së aktiveve jashtë përdorimi nuk ka përpiluar një raport përmbledhës për këto aktive të propozuara nga komisioni i inventarizimit. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (trajtuar më hollësisht në faqet 26-44 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

30.Rekomandim:

- Komisioni inventarizimit për cdo fletë inventari të mbajtur gjatë procesit të inventarizimit të bëjë shënimet përkatëse përmbri cdo aktiv mbi cilësinë e gjendjes fizike të tij, të përpilojë një raport vlerësimi paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre dhe t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues.

- Komisionet e inventarizimit të Aktiveve në MM të marri masat që në fund të çdo procesi inventarizimi të përpilojë raportin përmbledhës të gjendjes së aktiveve dhe të bëjë krahasimin e të dhënave të aktiveve që rezultojnë gjendje sipas inventarizimit fizik me gjendjen kontabël të regjistruar nga sektori i financës mbi bazën e fletëhyrjeve dhe fletë daljeve.

- Komisioni i vlerësimit mbështetur në propozimet e bëra nga komisioni i inventarizimit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve, duhet të përpilojë relacionin e vlerësimit ku përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit të vlerësimit.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

30. Gjetje: Nga auditimi i pasqyrës financiare të aparatit të Ministrisë së Mbrojtjes u konstatua se në formatin nr. 6 “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme” kolona 8 nuk përputhet me vlerën e aktiveve dalë jashtë përdorimi në vitin 2016 për vlerën prej 20,610,104 lekë, nga ku rezulton se vlera e aktiveve dhe vlera e amortizimit të akumuluar në pasqyrën financiare nuk është paraqitur në vlerë reale, duke sjellë pasaktësi jomateriale në pasqyrat financiare (*trajtuar më hollësisht në faqet 44-67 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

30. Rekomandimi:

Drejtoria e financës së MM të marri masa për të bërë rakordimin e vlerës së aktiveve të dala jashtë përdorimi nga komisioni i vlerësimit dhe të bëjë reflektimin e shumës në zërat përkatës të llogarive.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

32. Gjetje: Nga auditimi i pasqyrës financiare përmbledhëse për vitin 2016 dhe krahasimi i treguesve me vitin paraardhës u konstatua se periudha paraardhëse ka diferenca me pasqyrën financiare përmbledhëse të vitit 2015, përkatësisht në zërat e llogarive “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, “Disponibilitete në thesar”, ndryshimi në llogarinë “Fondet e veta”, “detyrimet afatshkurtra” dhe “te ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhëse”.me një diferencë prej 6,218,498 lekë, për të cilën nuk është dhënë asnjë sqarim shpjegues(*trajtuar më hollësisht në faqet 44-67 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

32. Rekomandimi:

Drejtoria e buxhetit të marri masat për rakordimin e të dhënave të dy pasqyrave financiare 2015 dhe 2016 dhe të rishikohet lëvizja e zërave, si dhe të pasqyrohen në vlera të sakta duke dhënë arsyetimet e duhura për ndryshimet e konstatuara.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

33. Gjetje: Nga auditimi i pasqyrës financiare të njëjësive shpenzuese u konstatua se në pasqyrën financiare për vitin 2015 të QKMBMMSH, IGJIU, KDS, Shtabi i Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Reparti Ushtarak 6640, në pasqyrën financiare për vitin 2016 të KDS, Instituti i Gjeologjisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Reparti Ushtarak nr. 6640, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe në pasqyrën financiare për vitin 2017 të QKMBMMSH, IGJIU, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve janë bërë transferime pakësim dhe nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve të trupëzuara, për të cilat nuk është zbritur vlera e amortizimit të akumuluar ndër vite për to, duke bërë që vlera e pasqyruar në pasqyrat financiare të jetë më e lartë, se vlera neto aktuale e inventarëve, veprime këto në kundërshtim me udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 të

Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (trajtuar më hollësisht në faqet 44-67 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

33. Rekomandimi:

Drejtoritë e Financës së njërive QKMBMMSH, Instituti i Gjeologjisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, KDS, Shtabi i Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Reparti Ushtarak 6640, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të marrin masa të menjëhershme për të rillogaritur amortizimin e akumuluar ndër vite (llogaria 219), për aktivet e nxjerra jashtë përdorimit, si dhe sistemimin dhe reflektimin e vlerave në llogarinë respektive duke rregulluar pasaktësi jo materiale në pasqyrat financiare

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

34. Gjetje: Nga auditimi i pasqyrës financiare të njërive shpenzuese u konstatua se në pasqyrën financiare të njësisë Policia Ushtarake për vitin 2015 është bërë pakësimi në Llogarinë 218 “Inventar ekonomik” dhe 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në shumën totale prej 40,279,780 lekë dhe për vitin 2017 është bërë pakësim në Llogarinë 215 “Mjete transporti” dhe 214 në vlerën totale prej 49,258,948 lekë, që përputhen me vlerën kontabël fillestare të regjistruar në kontabilitet. Në pasqyrën financiare të njësisë Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura (reparti ushtarak 6630) për vitin 2017 është bërë pakësimi në Llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe në Llogarinë 215 “Mjete transporti” në shumën 18,605,583 lekë. Njësitë kanë bërë pakësimin e zërit të amortizimit të akumuluar (llog. 219) me të njëjtën vlerë të pakësimit të aktiveve, duke sjellë pasaktësi jo materiale në pasqyrat financiare, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (trajtuar më hollësisht në faqet 44-67 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

34. Rekomandimi:

Drejtoria e Financës së Policisë Ushtarake dhe të Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të marrin masa të menjëhershme për të rillogaritur amortizimin e akumuluar ndër vite (llogaria 219) për aktivet e pakësuara dhe të bëjë paraqitjen e saktë të llogarive në pasqyrën financiare.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

35. Gjetje: Nga auditimi i pasqyrës financiare të njërive shpenzuese u konstatua se për pjesën më të madhe të njërive shpenzuese mungon relacioni shpjegues. Edhe në rastet kur është bashkëngjitur relacion shpjegues konstatohet se në relacionin e njësisë nuk japin sqarime dhe arsyetime për lëvizjet nga një vit në tjetrit në vlera të konsiderueshme të aktiveve të qëndrueshme, sqarime në lidhje me kalimin e kapitalit nga një institucion në një tjetër, si dhe lista e zërave të sistemuara brenda klasave të llogarive të realizuar nga institucionet.

Në relacione nuk ka bashkëlidhur tabelat e analizave të debitorëve; analizat e furnitorëve llogaria 401; kreditorëve në ruajtje llogaria 466 dhe analiza e kreditorëve për investime llogaria 467 etj duke bërë të pamundur të bëhet kuadrimi i llogarive analitike me llogarinë sintetike, për të vërtetuar nëse kemi përputhje të partitar-bilanc, si dhe për të bërë një ndarje të detyrimeve sa janë me shpresë arkëtimi apo likuidimi, sa janë krijuar mbi 10 vjet, sa nuk janë likuiduar apo arkëtuar për faj të strukturave që duhet të merren me to(trajtuar më hollësisht në faqet 44-67 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

35. Rekomandimi:

Të gjithë Drejtoritë e financës së njërive shpenzuese të MM të përpilojnë relacionin shpjegues në lidhje me pasqyrat financiare për çdo vit ushtrimor, të analizojnë në mënyrë të hollësishme debitorët, të sqaroje dhe argumentojë lëvizjet e aktiveve, si dhe të sqarojë të gjithë sistemimet e llogarive që realizohen brenda vitit ushtrimor.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

36. Gjetje: Raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi, si dhe raportet periodike që institucioni ka paraqitur në Ministrinë e Financës, nuk janë plotësuar me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel artikulli, lidhur më ndryshimet e planit të produkteve si në sasi ashtu edhe në vlerë. Mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikojnë në të ardhmen për realizimin e tyre.

- Përformanca e produkteve duhet të paraqitet e lidhur me realizimin e objektivave dhe politikës së programit, ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e programit si dhe si janë realizuar këto objektiva.

- Në raportet e monitorimit për 4 mujorët e vitit 2017 nuk është shprehur mbi masat korrigjuese që duhen ndërmarrë, sikundër e kërkon Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” (*trajtuar më hollësisht në faqet 159-165 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

36. Rekomandimi:

Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve buxhetore gjatë hartimit të raportit të monitorimit dhe raporteve periodike të cilat dorëzohen në Ministrinë e Financës, duhet të bëjnë argumentimet si cilësore ashtu dhe sasiore, si dhe të argumentojnë mosrealizimin e produkteve dhe të parashikojnë masat që duhet ndërmarrë në të ardhmen për realizimin e tyre.

Gjithashtu në përfundim të raportit të monitorimit për 4 mujorin e fundit të vitit, anëtarët e EMP (Ekipi i Menaxhimit të Programit) të shprehen mbi masat që duhet të merren për veprime korrigjuese në raste të mosrealizimit të planeve. Në rastet kur veprimet korrigjuese shkojnë përtej përgjegjësisë së anëtarëve të EMP, por brenda përgjegjësisë së anëtarëve të tjerë në institucion ose edhe jashtë, duhet të përfshihen si rekomandime në relacionin e raportit të performancës edhe argumentet mbështetës. Sa më sipër duhet t'i paraqiten koordinatorit të GMS-së, jo më vonë se 15.12.2017 (jo më vonë se java e dytë mbas përfundimit të 4 mujorit), në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

37. Gjetje. Nga auditimi u konstatua se, përgjatë periudhës objekt auditimi, Institucioni nuk ka hartuar planin strategjik, në mënyrë periodike për të reflektuar objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë nder sektoriale. Mos hartimi i Planin Strategjik, në institucion ka shkaktuar mos rishikimin e vazhdueshëm të objektivave të programeve, aktiviteteve dhe projekteve, që duhet të realizohen përmes proceseve të punës. Sa më sipër gjithashtu ndikon në mos përcaktimin e qartë të proceseve të punës. Në kundërshtim këto me bazën ligjore që rregullon fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

37. Rekomandimi:

Institucioni të marrë masa për të hartuar Planin Strategjik, i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre. Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

38. Gjetje. Nga auditimi u konstatua se, edhe pse është ngritur GMS për vitet objekt auditimi mungon dokumentimi i takimeve të realizuara apo problematikat e trajtuara, duke mos ofruar kështu siguri të arsyeshme mbi kryerjen ose jo të mbledhjeve të GMS-së, në kundërshtim me bazën ligjore që rregullon fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit (*trajtuar më hollësisht në faqet 159-165 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

38. Rekomandimi:

Nëpunësi autorizues, gjatë mbledhjeve të GMS te marrë masa mbi dokumentimin e mbledhjeve, dhe çështjeve/problematikave të trajtuara nga anëtarët e grupit të GMS, me qëllim gjurmimin e vendimeve të marra përgjatë takimeve të grupit dhe ndjekjen e zbatimit e tyre.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

39. Gjetje. Nga auditimi u konstatua se, në Ministrinë e Mbrojtjes nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve, me qëllim njohjen dhe shkëmbimin e përvojave mbi praktikën më të mira në fusha të ndryshme, në kundërshtim me bazën ligjore që rregullon fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit (*trajtuar më hollësisht në faqet 159-165 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

39. Rekomandimi:

Strukturat përgjegjëse (Sektorët /Drejtoritë dhe kështu me radhë sipas hierarkisë) të marrin masat e duhura për parashikimin e nevojave për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, dhe në bazë të këtyre parashikimeve të hartojnë dhe kryejnë trajnime specifike për punonjës të administratës mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin e nxjerrë në zbatim të tij (në veçanti për menaxhimin e riskut pasi u konstatua se, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e tij).

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

40. Gjetje. Nga auditimi u konstatua se, në Ministrinë e Mbrojtjes nuk janë marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit, e cila është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesit nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Në kundërshtim këto me bazën ligjore që rregullon fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit (*trajtuar më hollësisht në faqet 159-165 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

40. Rekomandimi:

Strukturat përgjegjëse të marrin masat e duhura për të siguruar kontrole efikase në menaxhimin e parasë publike. Pagesat të realizohen vetëm në rastet kur shpenzimi i realizuar është i shoqëruar me te gjithë dokumentacionin përkatës.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vijimësi

Ç. I. REKOMANDIME PËR MASA ZHDËMTIMI

1. Gjetje Në përgjithësi vlerat mujore të qirave të apartamenteve të përfaqësive dhe atasheve ushtarakë, janë të njëjta dhe kanë qëndruar për vite me radhë konstante të pa ndryshuara. Por në veçanti vlera mujore të qirasë së apartamenteve të Atasheut Ushtarak në SHBA dhe Përfaqësuesit Ushtarak në Kroaci kanë ndryshuar ndjeshëm duke u rritur në vlerë. Konkretisht:

-Atasheu Ushtarak në SHBA, ka pasur kontratë të lidhur për marrje apartamenti me qira me çmimin mujor 2,900 USD. Në vitin 2017, kjo kontratë qiraje është ndërprerë për shkak të zëvendësimit të Atasheut të parë dhe ardhjes së Atasheut të ri, i cili me miratim të Sekretari i Përgjithshme dhe më pas të Ministrit të Mbrojtjes ka lidhur kontratë tjetër për marrje apartamenti me qira me çmimin mujor 4,425 USD. Pra vlera e qirasë në muaj është rritur rreth 152% dhe që nga lidhja e kontratës Korrik 2017 deri në Korrik 2020 kemi rritjen e shpenzimeve në dëm të buxhetit të shtetit që shkon në shumën **54,900 usd**.

-Përfaqësuesi ushtarak në Kroaci, ka pasur kontratë të lidhur për marrje apartamenti me qira me çmimin mujor 900 euro. Në Gusht 2016 kjo kontratë qiraje është ndërprerë për shkak të zëvendësimit të Përfaqësuesit të mëparshëm dhe ardhjes së Përfaqësuesit ushtarak të ri, i cili me miratim të Sekretari i Përgjithshme dhe më pas të Ministrit të Mbrojtjes ka lidhur kontratë për marrje apartamenti me qira me çmimin mujor 2,100 euro. Pra vlera e qirasë në muaj është rritur rreth 230% dhe që nga lidhja e kontratës Gusht 2016 deri Gusht 2019 kemi rritjen e shpenzimeve pa

efektivitet në dëm të buxhetin të shtetit që shkon në shumën **43,200 euro** (trajtuar më hollësisht në faqet 19-26 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

1. Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në vlerën 54,900 usd dhe 43,200 euro

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

2. Gjetje: Nga auditimi u konstatua se, në katër përfaqësi ushtarake përveç shpenzimeve mujore për qiranë e apartamenteve, me miratimi i Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm, në zbatim të kontratave të lidhura është paguar dhe vazhdon të paguhet qira mujore edhe për përdorimin e disa pajisjeve shtëpiake, në kundërshtim me VKM, 305, date 12.03.2008 dhe Udhëzimin nr. 6, datë 02.05.2014, “Për disiplinimin e fondeve buxhetore në funksion të veprimtarisë së Atasheve & Përfaqësuesve Ushtarake”. Në asnjë nga kontratat e lidhur për marrjen me qira të pajisjeve shtëpiake nuk ndodhen të bashkëlidhur lista me inventarin e pajisjeve që janë marrë me qira.

Në pikën 1 të VKM, 305, date 12.03.2008 dhe pikën f, gj të Udhëzimit nr. 6, datë 02.05.2014 të sipërcituar përcaktohen qartësisht kategoritë e shpenzimeve që do të përballohen nga buxheti i MM dhe konkretisht, në germën f) përcaktohet se, mbulohen “shpenzimet për qira apartamenti dhe mirëmbajtje” dhe në germën g) përcaktohet se, mbulohen “shpenzimet për pajisje shtëpiake”.

Duket qartë se VKM, 305, date 12.03.2008 nuk përcakton se, buxheti i shteti mbulon shpenzime qiraje për përdorim pajisje shtëpiake, por vetëm shpenzime qira apartamenti, ndërsa për pajisjet përcakton shpenzime për blerjen e tyre.

Vlera e përgjithshme e qirasë së paguar për këto pajisje shtëpiake në dëm të buxhetit të shtetit llogaritet 32,760 euro dhe 107,256 usd. Pra në rast se, këto pajisje do të bliheshin në zbatim të germës g të VKM dhe të germës gj të udhëzimit, vlera e blerjeve të tyre do të ishte disa herë më e vogël se pagesat e qirasë mujore dhe për më shumë këto pajisje do të ishin në pronësi të MM dhe do të përdreshin për një kohë të gjatë nga përfaqësuesit ushtarake të tjerë. Konkretisht, paguhet qira për pajisjet shtëpiake nga këto përfaqësi:

- Përfaqësia ushtarake në Mons, T. M. ka paguar e vazhdon të paguaj qira çdo muaj duke filluar nga periudha Nëntor 2017 deri Nëntor 2017, me vlerën totale 14,760 Euro deri në fund të emërimit.
- Përfaqësia ushtarake në Gjermani, A. C, ka paguar e vazhdon të paguaj qira çdo muaj duke filluar nga periudha Gusht 2015 deri Gusht 2018, me vlerën totale 18,000 Euro deri në fund të emërimit.
- Përfaqësia ushtarake në Tampa/ShBA, J.M, ka paguar qira çdo muaj duke filluar nga periudha Gusht 2017 dhe do të vazhdoje të paguhet deri në Gusht 2019 që është edhe afati përfundimtar i kontratës, me vlerën totale për të gjitha periudhën e zbatimit të kontratës prej 19,080 usd.
- Përfaqësia ushtarake në Virginia/SHBA prej 3 vetash të emëruar për një periudhë 48 muaj kanë paguar e vazhdojnë të paguajnë qira çdo muaj në zbatim të kontratave dhe deri në përfundim të tyre, me vlerën totale 88,176 usd.

(trajtuar më hollësisht në faqet 19-26 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

2.Rekomandim: MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në vlerën 32,760 euro dhe 107,256 usd.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

3. Gjetje. Në disa procedura prokurimi të realizuara në zbatim të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” u konstatua se, AK ka hartuar dhe vendosur në Dokumentet e Tenderëve disa kërkesa të veçanta të pranimit kualifikimit në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik të cilat janë bërë shkak për s`kualifikimin e disa operatorëve të cilët kishin paraqitur oferta me te ultë se fituesit si dhe në disa procedura të tjera janë bërë s`kualifikime të pa drejta në kundërshtim me këto rregulla, të disa operatorëve ekonomik të cilët edhe këta kishin paraqitur oferta me te ultë se

operatorët fituesit. Nga këto shkelje apo veprime dhe mosveprime të AK i është shkaktuar buxheti të shtetit dëmi ekonomik vlerën **35,650,903 lekë**. Konkretisht këto shkelje janë konstatuar në këto procedura prokurimi (*trajtuar më hollësisht në faqet 73-121 të Raportit Përfundimtar të auditimit*):

3.1. “Blerje pjesë këmbimi për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit” e realizuar në vitin 2015, me fond limit në vlerën 45,442,738 lekë, shpallur fitues subjekti “A” dhe “S” me vlerë oferte 44,823,868 lekë.

Gjatë zhvillimit të kësaj procedurës, AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse disa kritere të veçanta kualifikuese nuk janë hartuar dhe përcaktuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet. Këto kërkesa janë hartuar teje të fryra, kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Këto shkelje janë bërë shkaqe të cilat KVO i ka shfrytëzuar duke bërë vlerësime subjektive duke s’kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “A & “R & R” me ofertë ekonomike më të ulët se operatori fitues. KVO nuk ju referua pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” për ti konsideruar këto mangësi devijime të vogla, me arsyetimin se: mungesa e një magazinë apo dyqani në funksion të realizimit të kontratës, mungesa e mjetit të transporti dhe mos punësimi 1 (një) inxhinieri mekanik nuk pengojnë operatorin dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kësaj kontrate, sepse kjo kontratë është me objekt blerje pjesë këmbimi të cila realizohet fare mirë nga çdo tregtar i vogël, i mesëm apo i madh, pa pasur dyqan, makine apo të punësuar inxhinierë mekanik. Nga këto veprime i është shkaktuar **buxheti të shtetit dëm ekonomik në vlerën 1,293,043 lekë**, me TVSH.

3.1. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërbimin e këtij dëmi në **shumën 1,293,043 lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

3.2. Gjetje. “Blerje artikuj ushqimorë për nevoja të KFD, Loti I” dhe “Blerje artikuj ushqimorë për nevoja të PU, Loti II”, të realizuar në vitin 2015. Loti I, me fond limit në vlerën 20,926,909 lekë është shpallur fitues BOE “Sh & E” me vlerë oferte 20,543,319 lekë. Loti II me fond limit në vlerën 3,427,318 lekë, është shpallur fitues operatori “Sh” me vlerë oferte 3,377,005 lekë.

-Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit në të dy Lotet, KVO ka s’kualifikuar operatorin “N” dhe operatori “K” nga të dy Lotet, sepse nuk kanë paraqitur lejen higjeno-sanitare për ambientin ku ushtron aktivitetin prodhim/tregtim buke dhe leje sanitare-veterinare për asnjë nga ambientet të cilat i ka deklaruar si vende të ushtrimit të aktivitetit. Mirëpo mungesa e këtyre dokumenteve nuk e pengojnë që këta operatorë të përmbushin me sukses kontratën e furnizimit. Të dy operatorët, kanë paraqitur licencë të kategorisë II.1.A “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve” dhe licencë të kategorisë II.1.B “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore”, çka tregojnë se, furnizimin e artikujve ushqimorë mundë ta bëjnë direkt nga prodhuesi ose nga tregtarët e shumicës për të AK, pa qenë nevoja që artikujt ushqimorë ti ruajnë në magazina apo dyqanet e tyre, mjafton që furnizimi të bëhet më kamioni frigoriferik, për të cilët të dy operatorët kanë paraqitur dokumente që e vërtetojnë që i kanë këto makineri së bashku me lejen higjeno-sanitare të tyre. Pra mos paraqitja e lejet higjeno-sanitare dhe veterinare për vendet dhe ambientet e tregtimit nuk pengojnë furnizimin e produkteve ushqimorë. Si pasoje e s’kualifikimeve në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik i është shkaktuar buxheti të shteti dëm ekonomik **në vlerën 4,838,636 lekë, me TVSH**, respektivisht, 4,080,226 lekë, në lotin I dhe 758,410 lekë në Lotin II. (Kjo vlerë llogaritet si diference e vlerës së ofertës së operatorit “N” me vlerën e ofertës së operatorit fitues “Sh & “E” për lotin e I dhe operatorit fitues “Sh.” për lotin e II).

3.2. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në **shumën 4,838,636 lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

3.3. Gjetje. “Rikonstruksion i njeve sanitare dhe hidroizolim tarrace të godinës tre katërshe të IGJIU” e realizuar në vitin 2015, me fond limit në vlerën 4,044,487 lekë.

Procedura e prokurimit është zhvilluar **në datën 16.02.2015** dhe kanë marrë pjesë 21 operatorët ekonomik. KVO ka kualifikuar 8 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori “E. ”, me ofertën ekonomike në vlerën 3,033,604.5 lekë dhe ka s’kualifikuar 13 operatorët e tjerë. Nga 13 operatorët e s’kualifikuar, 4 prej tyre janë s’kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik, ndërsa 9 të tjerët janë s’kualifikuar sepse, nuk plotësonin vetëm kërkesën për shlyerjen e detyrimeve të **maturuara** të energjisë elektrike. S’kualifikimi i operatorëve të mësipërm bie në kundërshtim me nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në këtë nen kërkohet, një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të **maturuara të energjisë elektrike** të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mirëpo, këta operatore e kanë plotësuar këtë kërkesë, kjo tregohet qartë nga vërtetimet e lëshuar nga OSSHE për këta operator, me anë e të cilave vërtetojnë se, nuk kanë detyrime të pashlyera ndaj OSSHE, si dhe me këto vërtetime, tregohet se energjia elektrike e konsumuar gjatë muajit dhjetor 2014 dhe muajit janar 2015 nuk është lexuar nga faturisti (lexuesi i aparatit matës), pra nuk është faturuar (maturuar) sepse në të kundërt, energjinë të lexuar dhe të faturuar për muajin dhjetor 2014 do ta tregonte sistemin e Faturimit të OSSHE dhe do të pasqyrohej në vërtetimin e lëshuar nga OSSHE. Veçanërisht dy operatorët të cilët kane paraqitur ofertat me vlerë më të ulët se pjesëmarrësit e tjerë, respektivisht operatori “N” dhe “N” kane paraqitur vërtetimet të lëshuara nga OSSHE në datën 10.01.2015 dhe 30.01.2015 ku, **rezultojnë se kanë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, pa përfshirë faturën koherente të muajit dhjetor 2014 dhe janar 2015.** Pra këta operatorë nuk ka detyrime të pashlyera ndaj OSSHE, si dhe nuk vërtetohet se energjia elektrike e konsumuar gjatë muajit dhjetor 2014 apo janar 2015 të jete faturuar (maturuar) nga faturisti (lexuesi i aparatit matës) sepse në të kundërt, energjinë të lexuar dhe të faturuar për muajin dhjetor 2014 apo janar 2015 do ta tregonte sistemin e Faturimit të OSSHE dhe do të pasqyrohej si debitor për këto muaj në vërtetimin e lëshuar nga OSSHE. S’kualifikimi i operatorëve të mësipërm është edhe në kundërshtim me Vendimin e Entit Rregullator të Energjisë nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë”, vendim i cili përcakton qartësisht procedura për leximin e matësit të energjisë, faturimi i energjisë elektrike, pagesa dhe afatin e tyre. Dhe sipas afateve të këtij vendimi, klienti ka detyrimin e pagesës së konsumit për muajin dhjetor 2014 deri në 31 janar 2015 dhe në rastë të mos pagesës deri në këtë afat duhet ta paguaj këtë pagësë brenda muajit shkurt 2015 me kamatvonesë dhe në rastë të mospagesës tej këtij afati, atëherë del debitor dhe futen sanksione e tjera (ndërprerja e energjisë, tj.). Si pasojë e s’kualifikimeve në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik i **është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 570,437 lekë**, e cila llogaritet si diferencë e vlerës së operatorit fitues “E” me vlerën e ofertës së operatorit “N” i cili duhej të kualifikohej dhe të shpallej fitues se kishte ofertën në vlerën me të vogël se ky operator.

3.3. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në **shumën 570,437 lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

3.4. Gjetje. “Shtesë depo karburanti JET A1, në Bazën Ajrore Farkë” e realizuar në vitin 2015, me fond limit në vlerën 34,434,130 lekë.

AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse disa kritere të veçanta kualifikuese nuk janë hartuar dhe përcaktuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet, janë hartuar, kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Ndër të tjera është e kërkuar që, operatorët ekonomik duhet të dëshmojë se kanë të punësuar punëtor të kualifikuar si: 1 elektrikist, 1 hidraulik, 1 mekanik dhe 2 saldator, të pajisur me dëshmi kualifikimi (diplomë shkolle certifikata kualifikimi, trinime) dhe duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën janar – maj 2016). Vendosja e këtyre kërkesave është bërë shkak për s'kualifikim të padrejtë të 2 operatoreve pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht, në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 4 operatore ekonomik. KVO, ka kualifikuar vetëm operatori ekonomik “B.S” i cilët është shpallur edhe fitues me ofertën ekonomike në vlerën 29,264,241 lekë dhe ka s'kualifikuar 3 operatorët e tjerë, dy nga të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulta se operatori fitues. Gjate shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, KVO ka përdorur dy standarde në vlerësimin e kapaciteteve teknike të ofertuesve sepse, nga njëra anë ka s'kualifikuar me pa të drejtë operatorët ekonomik “M.S” dhe “K” të cilët kanë paraqitur ofertat më të ulta se operatori fitues, me pretekstin se kanë mangësi, por këto mangësi janë shumë të vogla dhe nuk e pengojnë ekzekutimin me sukses të kontratës apo janë mangësi të sajura nga vetë KVO siç është rasti i formatit të deklaratës së konfliktit të interesit të operatorit M.S. Nga ana tjetër ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues operatorin “BI” i cili edhe ky, ka paraqitur dokumentacionin me mangësi të vogla si të dy operatorët e tjerë. Nga ky veprim i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik i cili llogaritet si diferencë e ofertës së operatorit “B.I” të shpallur fitues dhe dy operatorëve të tjerë të s'kualifikuar në kundërshtim me LPP. Konkretisht, Operatori ekonomik “M.S” dhe Operatori ekonomik “K” duhet të ishin kualifikuar për fazën tjetër atë të shqyrtimit ekonomik sepse i plotësonin të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kërkuara në DT. Dhe nga shqyrtimi i ofertës ekonomike, operatori ekonomik “K” duhej të shpallej fitues sepse kishte paraqitur ofertën më të ulët se dy operatorët e tjerë të kualifikuar. Për pasojë, diferenca e vlerës së ofertës së operatorit fitues “BI” me vlerën e ofertës së operatorit “K” **përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit e cila llogaritet në vlerën 8,931,708 lekë, me TVSH..**

3.4. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërbimin e këtij dëmi në **shumën 8,931,708 lekë.**

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

3.5. Gjetje. “Blerje materiale bazë për stërvitje” e realizuar në vitin 2016, me fond limit në vlerën 16,966,080 lekë. Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatore ekonomik dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori “B.” me ofertën ekonomike në vlerën 16,550,480 lekë, ndërsa operatori tjetër “B.K” është s'kualifikuar se, nuk ka të konfirmuara kopjet e bilanceve të viteve 2014 dhe 2015 nga organet tatimore dhe nuk ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2008 të prodhuesit dhe katalogun e prodhuesit për artikujt e përfshirë në skedën teknike. Por nga auditimi rezultoi se, ky operatore i ka plotësuar këto kërkesa të veçanta: ka hedhur ne sistemin elektronik kopjet e bilanceve të viteve 2014 dhe 2015, të cilat janë të vulosura nga Drejtoria Rajonale Berat në faqen e parë të tyre si dhe ka hedhur ne sistemin elektronik kopje të noterizuar të certifikatës ISO 9001:2008, dhe katalogun për artikujt e kërkuar. Pra, s'kualifikimi i operatorit “B. K.” është bërë në kundërshtim, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”. Nga kjo shkelle i **është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 3,142,776 lekë, me TVSH,** sepse operatore “B. K” duhej të kualifikohesh dhe të shpallej fitues pasi kishte ofertën më të ulët në këtë vlerë se oferta e operatorit “B.”.

3.5. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 3,142,776 lekë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

3.6. Gjetje. “Blerje artikuj ushqimorë” për nevoja të KFD, e realizuar në vitin 2016, me fond limit në vlerën 15,822,912 lekë.

Në tenderin e zhvilluar në datë 07.03.2016 kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik dhe është kualifikuar vetëm operatori “Sh& “E” i cili është shpallur fitues me ofertën ekonomike në vlerën 15,544,398 lekë dhe janë s’kualifikuar 2 operatorët të cilët kanë paraqitur oferta më të ultë se fituesi. Njëri prej operatorëve “L&Zh” është s’kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse nuk plotëson disa të Kriterëve të Veçanta për kualifikim, ndërsa operatori tjetër “K” është s’kualifikuar sepse për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, me vërtetimin e lëshuar nga OSSHE, me nr. 964, datë 03.02.2016 nuk vërteton plotësimin e kërkesës për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, për energjinë e maturuar të muajit janar 2016. Mirëpo, ky operator e plotëson këtë kërkesë, e cila tregohet qartë nga vërtetimi i lëshuar në datën 03.02.2016 nga OSSHE, me anë e të cilin vërteton se: *“nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 02.02.2016, pa përfshirë faturën koherente të muajit janar 2016.* Pra ky operatorë nuk ka detyrime të pashlyera ndaj OSSHE, si dhe nuk vërtetohet se energjia elektrike e konsumuar gjatë muajit janar 2016 të jete faturuar (maturuar) nga faturisti (lexuesi i aparatit matës) sepse në të kundërt, energjinë të lexuar dhe të faturuar për muajin janar 2016 do ta tregonte sistemin e Faturimit të OSSHE dhe do të pasqyrohej si debitor për këto muaj në vërtetimin e lëshuar nga OSSHE. s’kualifikimi i këtij operatori është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe me Vendimin e ERRE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë” i cili përcakton qartësisht procedura për leximin e matësit të energjisë, faturimi (maturimin) i energjisë elektrike, pagesa dhe afatin e tyre. Si pasojë e këtij s’kualifikimi i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 2,361,759 lekë e cila llogaritet si diferencë e vlerës së operatorit fitues “Sh& E” me vlerën e ofertës së operatorit “K” i cili duhej të kualifikohet dhe të shpallej fitues se kishte ofertën në vlerën me të vogël.

3.6. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 2,361,759 lekë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

3.7. Gjetje. “Rikonstruksion i njejeve h/sanitare të godinës së stërvitjes individuale bazë SIA dhe SIB në Shkollën e Trupës, Bunavi Vlorë i ndarë në dy Lote” të realizuar në vitin 2016. Loti I, me fond limit në vlerën 15,220,775 lekë dhe Loti II me fond limit në vlerën 18,091,502 lekë. Në të dy lotët është shpallur fitues operatori “K. I” për Lotin I me vlerë oferte 14,369,236 lekë dhe për Loti II me vlerë oferte 17,251,782 lekë.

AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse në DT të të dy lotëve ka vendosur disa kritere të veçanta kualifikuese të cilat nuk janë hartuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet, janë hartuar, kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Konkretisht, ndër të tjera është kërkuar që, operatorët ekonomik duhet të dëshmojë se kanë të punësuar punëtor të kualifikuar si: “hidraulik, mekanik, teknik ndërtimi, specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, punonjës të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi për; montim skeleri/suvatim fasade/lyerje fasade/parapet tarrace, etj. Të gjithë këta punonjës duhet të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi, diplom shkollë, certifikata kualifikimi, trainime, etj, dhe

duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar (Janar – Maj 2016). Vendosja e këtyre kërkesave është bërë shkak për s`kualifikim të padrejtë të 4 operatoreve pjesëmarrës në procedurën prokurimit në të dy lotet. Në tenderin e zhvilluar në datën 22.07.2016 në të dy lotet kanë marrë pjesë 6 operatore ekonomik të njëjtë, janë s`kualifikuar nga të dy lotët 5 operatorët, 4 nga të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulta se operatori fituesit për të dy lotët. Nga të 5 operatorët e s`kualifikimit përveç 1 operatori (“E”) që është s`kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik, 4 operatorët e tjerë janë s`kualifikuar vetëm për mos plotësim të kriterëve të veçanta që kanë të bëjnë me mosparaqitjen e dokumentacionit për të vërtetuar se, kanë pjesë të stafit punonjës të kualifikuar të sipërcituar. Pra nuk kanë paraqitur dëshmi, certifikatë ose diplomë që të vërtetojë kualifikimin profesional të tyre, apo dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Mirëpo, siç u tha, këto kriterë të veçanta janë vendosur të ekzagjeruara sepse për të vërtetuar që operatorët kanë eksperience në këtë fushë është kërkuar dhe këta operator kanë paraqitur kontratat e ngjashme të cilat vërtetojnë më së miri se, kanë kryer me sukses gjatë tre viteve të fundit punë të ngjashme të kësaj natyre. Për më tepër duke ju referua pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” këto mangësi konsiderohen lehtësisht devijime të vogla, me arsyetimin se, nuk e pengojnë operatorin dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës, sepse kjo kontratë është me objekt të thjeshtë “Rikonstruksion i nyjeve h/sanitare...” dhe kryerja e këtyre punimeve nuk kërkon punëtorë të pajisur me certifikata, diploma apo orë trajnimi (rikonstruksioni i tualeteve kryhet brenda ndërtesës dhe nuk kanë nevojë për punonjës të trajnuar për punime lartësie, etj). Nga këto veprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik i cili llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit fitues “K.I” dhe vlerës së ofertës së operatorëve të tjerë të s`kualifikuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, këta operatorë duhet të ishin kualifikuar për fazën tjetër atë të shqyrtimit ekonomik dhe pas shqyrtimit të ofertave ekonomike, duhej të shpallej fitues operatori ekonomik “K. C” sepse kishte paraqitur ofertën më të ulët se operatori fitues dhe operatorët e tjerë. Për pasojë, diferenca e vlerës së ofertës së operatorit fitues “K. I” me vlerën e ofertës së operatorit “K. C” përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit e cila llogaritet në vlerën 8,734,189 lekë, me TVSH, respektivisht, 5,419,408 lekë për lotin I dhe 3,314,781 lekë për Lotin e II.

3.7. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërbimin e këtij dëmi në shumën 8,734,189 lekë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

3.8. Gjetje. “Ndërtim depo karburanti në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau Dejës, Shkodër” e realizuar në vitin 2016, me fond limit në vlerën 12,870,092 lekë.

Procedura e prokurimit është zhvilluar në datën 16.03.2016 dhe kanë marrë pjesë 2 operatorët ekonomik. KVO ka kualifikuar operatorin “B.I” i cili është shpallur fitues, me ofertën ekonomike në vlerën 12,613,554 lekë dhe ka s`kualifikuar operatorit tjetër “K” i cili ka ofertën me të ulët se fituesi. S`kualifikimi i këtij operatori është bërë sepse nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e disa kriterëve të veçanta për kualifikim si: deklaratë mbi shoqërinë prodhuese dhe autorizim e lëshuar nga prodhuesi se do të furnizojë operatorin ekonomik me rezervuarët/depozitat sipas projektit, si dhe dokumente me anë të të cilave të vërtetojë eksperiencën e prodhuesit të deklaruar në prodhimin e rezervuarëve/depozitave të karburantit (kontrata, fatura shitje, etj.). Por lidhur me dokumentacionin e sipërcituar, ofertuesi ka paraqitur një deklaratë “Rezervuarët e karburantit që do të instalohen do të prodhohen nga shoqëria jonë me eksperiencë në këtë fushë pasi ka ndërtuar 2 karburante”. KVO, nisur nga deklarata e paraqitur, verifikoi në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar dhe rezultoi se, ofertuesi nuk ka si objekt të ushtrimit të aktivitetit prodhimin e depozitave të karburantit ose depozitave të gazit dhe në këto kushte, operatori ekonomik s`kualifikohet. Por, nga auditimi mbi ligjshmërinë e këtij s`kualifikimi rezultoi se, ky operatorë

është s`kualifikuar ne kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi pretendimi i KVO nuk ka të bëjë me objektin e veprimtarisë së këtij operatori sepse, prodhimi i depozitave të karburantit ose depozitave të gazit apo i depozitave të çfarë do lloji nuk janë veprimtari me vete, por përfshihen në veprimtarinë e punëve të ndërtimit të cilat ofertuesi sipas Ekstraktit QKR kryhen veprimtari, ndërtimi, montimi, prodhime materiale ndërtimi, ujësjellësa, silose kulla uji, kulla beton arme, metalike, etj. Për më tepër, eksperiencën në prodhimi i depozitave të karburantit ose depozitave të gazit dhe instalimin e tyre ky operator e vërteton me kontratën e ngjashme që ka paraqitur në sistemin elektronik. Konkretisht ka paraqitur, kontratën për ndërtimin e kompleksit të shërbimeve (Autogrill) në Blinisht në rrethin Mirditës (autostrada Durrës-Kukës). Pra nga njëra anë kjo kontratë e konsideron në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe nga ana tjetër nuk merr në konsideratë furnizimin dhe vendosjen e depozitave të karburantit të kryera sipas kësaj kontrate, por ngre pretendimin me pa të drejte se nuk ka të regjistruar si, objekt të ushtrimit të aktivitetit prodhimin e depozitave të karburantit ose depozitave të gazit. Nga ky veprim i **është shkaktuar buxhetit të shtetit dëme ekonomik në vlerën 1,432,456 lekë**. Ky dëm, llogaritet nga diferenca e vlerës së ofertës të operatorit fitues “BI” me vlerën e ofertës të operatorit “K” të s`kualifikuar në kundërshtim me LPP.

3.8. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërbimin e këtij dëmi në **shumën 1,432,456 lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

3.9. Gjetje. “Rikonstrukcion i objektit dykatësh, ish biblioteka e KDS-së me destinacion Qendër e Ekselencës” të realizuar në vitin 2017, me fond limit 68,007,365 lekë, me operator fitues “I” me vlerë oferte 45,400,279 lekë.

AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse në DT ka vendosur disa kriteret të veçanta kualifikuese të cilat nuk janë hartuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet, janë hartuar, kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Ndër të tjera është kërkuar që, operatorët ekonomik duhet të dëshmojë se kanë të punësuar punëtor të kualifikuar si: punëtor që përmbush kriteret për të qenë *koordinator/përgjegjës për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit; punëtor të trajnuar/certifikuuar për punimet në lartësi; punëtor të kualifikuar si: 2 teknik ndërtimi, 3 elektrikist, 3 hidraulik, 1 mekanik, 2 saldator dhe 3 bojaxhi. Të gjithë këta punëtor duhet të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi, diplom shkollë, certifikata kualifikimi, trainime, etj, dhe duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik 2016 - korrik 2017. Vendosja e këtyre kërkesave është bërë shkak për s`kualifikim të padrejtë të 1 (një) operatori pjesëmarrës në procedurën prokurimit. Konkretisht, në tenderin e zhvilluar në datën 22.9.2017 kanë marrë pjesë 8 operatore ekonomik, janë s`kualifikuar 4 operatorë, nga të cilët BOE “E&R” është s`kualifikuar se, nuk plotëson kriteret të veçanta që kanë të bëjnë me mosparaqitjen e dokumentacionit të sipërcituar për të vërtetuar se, ka pjesë të stafit punëtor të kualifikuar (*bojaxhi, hidraulik, punëtor të trajnuar/certifikuuar për punimet në lartësi, për sigurinë dhe shëndetin, etj.*) si dhe njëri nga anëtarët e shoqërisë operatori “R” nuk disponon gjendje parash në llogari të tij në vlerën e kërkuar në dokumentet e tenderit dhe në raport me përqindjen e pjesëmarrjes. Por, siç u tha më sipër, kriteret e veçanta që lidhen me punëtorët e kualifikuar, janë vendosur të ekzagjeruara sepse për të vërtetuar që operatorët kanë eksperience kanë paraqitur kontratat e ngjashme të cilat vërtetojnë më së miri se, kanë realizuar me sukses gjate tre vitet e fundit punë të ngjashme të kësaj natyre. Po kështu edhe arsye tjetër e s`kualifikimi se, operatori “REJ” nuk disponon gjendje parash në llogari të tij në vlerën e kërkuar dhe në raport me përqindjen e pjesëmarrjes është mangësi e pa përfillshme sepse vetë AK pothuajse në të gjitha*

procedurat e prokurimeve si, civile, ushtarake dhe sekretet të kufizuara të realizuara më parë apo pas kësaj procedure nuk ka kërkuar në DT që operatorët duhet të kenë gjendje para në vlerën 10% të fondit limit. Ndërsa në këtë procedurë e kërkon këtë kriter e cila bëhet edhe shkak për s'kualifikim. Duhet theksuar se, anëtari tjetër i kësaj shoqërie "E" i cili është edhe lideri i shoqërisë ka gjendje në llogari sa dyfishi i parave të kërkuara në DT, në këto kushte kjo kërkesë e pa plotësuar nga operatori "R", plotësohet nga anëtari tjetër. Për me tepër, nisur nga vlera e ofertës më të ulët, në referim të pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" këto mangësi konsiderohen lehtësisht devijime të vogla se, ato nuk pengojnë dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës, pasi kjo kontratë është me objekt të mirënjohur, rikonstruksion godinë 2 katesh. Punimet e rikonstruksionit realizohen me punëtorë të thjeshtë pa qene nevoja të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi apo trajnime për lartësi deri në dy kate, etj, etj. Edhe kërkesa që, këta punëtorë, domosdoshmërisht duhet të ishin të punësuar nga operatorët për një periudhë një vjeçare të mëparshme, është kërkesë shumë diskriminuese, dhe pothuajse asnjë operatore që është në treg nuk e plotëson sepse një punëtorë i caktuar p.sh, saldatori, hidrauliku, bojaxhiu, etj, mund të punojnë sipas nevojës që kanë operatorët për punë të caktuar dhe me kohe të pjesshme apo me nenkontraktim pa qenë e nevoja që këta të jenë detyrimisht të punësuar për një periudhë një vjeçare . Nga këto veprime i **është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 4,081,880 lekë, me TVSH**. Ky dëm llogaritet nga diferenca e vlerës së ofertës të operatorit fitues "I" me vlerën e ofertës të operatorit "E&R", i cili është s'kualifikuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik".

3.9. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në **shumën 4,081,880 lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

4. Gjetje. Dosja e teknike të zbatimit me objekt "*Rikonstruksionit të nyjeve të përgjithshme sanitare në godinën nr.14 (AFA) dhe godinën nr. 16 (QBO)*" ndarë në 2 lote, Loti I "Rikonstruksion i nyjeve të përgjithshme sanitare në godinën nr. 14 (AFA)" me vlerë 5,809,093 lekë pa TVSH dhe Loto II "Rikonstruksion i nyjeve të përgjithshme sanitare në godinën nr. 16 (QBO)" me vlerë 7,122,013 lekë pa TVSH. Punimet janë kryer sipas kontratës për punë publike, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Ministrisë së Mbrojtjes dhe operatorit ekonomik "E". Nga verifikimi me sondazhe në objekt, librezës së masave dhe situacionit përfundimtar për të 2 Lotet, u konstatuan disa pasaktësi në përfitime të padrejta nga sipërmarrësi "E" të cilat konsistojnë në punime të pakryera dhe të mbivendosura, duke i shkaktuar ***dëm ekonomik në vlerën 495,540 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit)***.

4. Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore ***për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 495,540 lekë***, nga sipërmarrësi i punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

5. Gjetje. Dosja e teknike të zbatimit me objekt "*Rikonstruksioni i Dhomave të Ndalimit Disiplinor*" me vlerë 9,657,759 lekë pa TVSH, është kryer sipas kontratës të lidhur midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe operatorit ekonomik "E". Nga verifikimi me sondazhe në objekt, librezës së masave dhe situacionit përfundimtar, u konstatuan disa pasaktësi në përfitime të padrejta nga sipërmarrësi "E", për shkak të pasaktësive në llogaritje dhe në zëra pune të mbivendosura, duke shkaktuar ***dëm ekonomik në vlerën 41,400 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit)***.

5. Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 41,400 lekë, nga sipërmarrësi i punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

6. Gjetje. Dosja e teknike të zbatimit me objekt "*Shtesë Depo Karburanti Jet A1 në Bazën Ajrore Farkë*", me vlerë 29,264,241 lekë pa TVSH, është kryer sipas kontratës të lidhur midis Komandës së Forcës Ajrore dhe operatorit ekonomik "B.". Zbatimi i kontratës ka pasur disa problematika lidhur preventivin e punimeve, në të cilën është kërkuar fond shtesë për depon e karburantit Jet A1 në Bazën Ajrore Farkë. Me shkresën e Institutit Gjeografik dhe Infrastrukturës Ushtarake, i kthehet përgjigje Komandës së Forcës Ajrore, duke miratuar shtesën e kontratës dhe duke hartuar preventivin e shtesës së kontratës në vlerën prej 3,465,000 lekë, me TVSH. Nga verifikimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar të kontratës fillestare dhe kontratës shtesë, u konstatua pasaktësi, në zërat e ndryshimeve të aksesorëve, pasi situacionit të shtesës së kontratës, ku u miratuan dhe u likuiduan ndryshimet për aksesorët, në të cilën përfshihen gomina, kapakë, valvula, bryla, T-i, adaptorë, manikota, filtra, bulona, dado, niples etj, përbëjnë aksesorët komplet të depove të karburantit. Rrjedhimisht në kapitullin B të punimeve mekanike, zërat nr. 11, nr. 12 "*F.V aksesorë e linjës së furnizimit (ngarkimit)*" dhe "*F.V aksesorët e linjës së shpërndarjes (thithjes)*", të likuiduara në situacionin përfundimtar të kontratës fillestare, përbëjnë zëra pune të dubluara dhe të përfituara padrejtësisht nga sipërmarrësi, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 213,120 lekë**.

-Ndryshimet e projekt-preventivit të kontratës, duke rritur vlerën e kontratës për shkak të ndryshimeve të specifikimeve dhe parametrave teknike, përbën tjetërsim të procedurës tenderuese. Vlera e shtesës së kontratës prej 3,465,000 lekë me TVSH, përbën përdorim jo me economicitet, eficensë dhe efektivitet të fondeve publike, pasi është shmangur procedura e hapur e tenderimit, nga ndryshimet e specifikimeve teknike (*trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

6. Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 213,120 lekë, nga sipërmarrësi i punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

7. Gjetje. Dosja e teknike të zbatimit me objekt "*Rehabilitimi dhe vënia në shfrytëzim e depozitave të karburantit 500 M³, Pashaliman, Vlorë*", me vlerë 32,291,438 lekë pa TVSH, është kryer sipas kontratës, të lidhur midis Komandës së Forcës Detare dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "N&K". Nga auditimi i situacionit përfundimtar, në punimet e depozitave (2 copë) mbrojtja nga korrozioni, është likuiduar zëri i "*Montim, testim, inspektim dhe certifikim i depozitave*" në zërin nr. 13, në kundërshtim me dispozitat ligjore të kontratës neni 26.1, ku citohet se "*Sipërmarrësi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Sipërmarrësi brenda çmimit të kontratës*". Në kapitullin e mbrojtjes së korrozionit përfshihet pastrimi, lyerja, materiale dhe elemente ndihmësi si skela, rrëshirë, Fv valvul, Fv saraçineska, Fv fllanxha, Fv tuba çeliku dhe Fv kabull. Pra nuk është e qartë se pse është vendosur zëri i montimit bashkë me testet, inspektimet apo certifikimet. Rrjedhimisht bazuar kontratës zëri i "*Montim, testim, inspektim dhe certifikim i depozitave*", **në vlerën 156,000 lekë përbën dëm ekonomik**, në përfitim të padrejtë për sipërmarrësin (*trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

7.Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 156,000 lekë, nga sipërmarrësi i punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

8. Gjetje. Dosja e teknike të zbatimit me objekt "*Rrethimit të jashtëm të Bazës Ajrore Farkë*", me vlerë 18,082,202 lekë pa TVSH, është kryer sipas kontratës për punë publike të lidhur midis Komandës së Forcës Ajrore (Rep. Ushtarak nr. 3001) dhe operatorit ekonomik "P". Nga verifikimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimet në terren, u konstatua pasaktësi mbi peshën e profilit metalik të rrethimit. Në faqen zyrtare të kompanisë "P", në katalogun zyrtar të vitit 2016, u konstatua se pesha e profilit 50x50x4mm është 6.03 kg/ml. Në total pesha e përfituar më tepër është 741 kg, me çmimin përkatës prej 110 lek, rezulton vlera prej **97,812 lekë e cila përbën dëm ekonomik**, në përfitim të padrejtë për sipërmarrësin (*trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

8.Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore **për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 97,812 lekë**, nga sipërmarrësi i punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

9. Gjetje. Dosja e teknike të zbatimit me objekt *Rikonstruksioni i objektit nr. 10 (godina 2 kate) Babrru, për nevoja të komandës së flotës tokësore*", me vlerë 9,194,962 lekë pa TVSH, është kryer sipas kontratës të lidhur midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe operatorit "H". Nga verifikimi me sondazhe të librezës së masave dhe situacionit përfundimtar, zërave të fondit rezervë u konstatua pasaktësi. Në korrespondencat e palëve, mbi përdorimin e fondit rezervë është shprehur se shtresa e lustrës do të përdoret për të mundur shtrimin e pllakave në sasinë 762 m² ndërkohë, në situacionin përfundimtar, kapitulli i punimeve të shtresave, zëri nr. 2 me nr. anal 2.267 /b "*Shtresë me pllaka grez importi cil. I-rë*" sasia e vendosjes së pllakave është 762 m². Rrjedhimisht në situacionin përfundimtar zëri nr. 2, me nr. anal. 2.200 "*Shtresë lustrë çimento 1:2, t=20mm*", në sasinë 526 m², është i paarsyeshëm dhe i mbivendosur në fondin rezervë e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi "H", për punime të pakryera dhe të mbivendosura, duke i shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 239,856 lekë** (*trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

9.Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore **për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 239,856 lekë**, nga sipërmarrësi i punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

10. Gjetje. Dosja e teknike të zbatimit me objekt "*Rikonstruksion Depo Karburanti, Linzë*" me vlerë 9,348,486 lekë pa TVSH, është kryer sipas kontratës të lidhur midis Komandës Mbështetëse dhe operatorit ekonomik "A". Nga auditimi i situacionit përfundimtar, në shtesën e kontratës është likuiduar zëri i zëri "*Ujë (për testimin në hermeticitet të depozitës)*" në vlerën 75,000 lekë, në kundërshtim me kushtet e kontratës neni 34.1 dhe në kundërshtim me specifikimet teknike "*Sipërmarrësi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Sipërmarrësi brenda çmimit të kontratës*" Rrjedhimisht bazuar kontratës zëri i "*Ujë (për testimin në hermeticitet të depozitës)*", **në vlerën 75,000 lekë përbën dëm ekonomik**, në përfitim të padrejtë për sipërmarrësin (*trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

10. Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore **për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 75,000 lekë**, nga sipërmarrësi i punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

11. Gjetje. Dosja e teknike të zbatimit me objekt "*Rikonstruksioni i nyjeve hidrosanitare të godinës së stërvitjes individuale (SIA) dhe (SIB), në shkollës Bunavi Vlorë*" e ndarë në 2 lote. Lot I "*Rikonstruksionit të nyjeve h/sanitare të godinës së stërvitjes individuale të avancuar (SIA), në Shkollën e trupës, Bunavi Vlorë*", me vlerë 14,369,236 lekë pa TVSH dhe Loti II "*Rikonstruksionit të nyjeve h/sanitare të godinës së stërvitjes individuale të avancuar (SIB), në Shkollën e trupës, Bunavi Vlorë*", me vlerë 17,251,782 lekë pa TVSH, janë kryer sipas kontratave të lidhura midis MM dhe operatorit ekonomik "K.I". Nga verifikimi me sondazhe në objekt, librezës së masave dhe situacionit përfundimtar për të 2 Lotet, u konstatuan disa pasaktësi në përfitime të padrejta nga sipërmarrësi "K.I", për punime të pakryera dhe të mbivendosura, duke i shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 436,896 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 132-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

11. Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore **për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 436,896 lekë**, nga sipërmarrësi i punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Menjëherë

12. Gjetje. Në datën datë 20.07.2009 MM ka lidhur kontratën me operatorit ekonomik "Infinit Construstions". me objekt "*Ndërtim Hangar Mirëmbajtje për Helikopterët*" me vlerë 70,025,172 me TVSH. Kontratës bazë i janë bërë disa amendime për problematkat e dala gjatë zbatimit të projektit. Problematika konsiston se gjatë zbatimit të projektit u realizuan punime për spostimin e objektit me qëllim largimin e kolektorit kryesorë, i cili u realizua me thellim nën kuotën e parashikuar në projekt për shkak të mos gjendjes së tabanit, ku u krye edhe mbushja me zhavorr për tu ngritur deri në kuotën e fillimit të plinteve. Sipas sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve kryerja e këtyre punimeve ka kërkuar një kohë të gjatë, deri më datë 11.05.2010. Për shkak të mos realizimit të procesit të kalandrimit të kapriadave, shoqëria "I.C" ka kërkuar serish shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve në objekt, e cila është miratuar nga AK shtyrje të afatit deri më datë 11.12.2010. Realizimi i kontratës deri më datë 17.12.2010 ishte 67,985,054 lekë me TVSH, nga 70,025,172 me TVSH, ku është ngelur pa realizuar vlera prej 2,040,121 lekë me TVSH. Për realizimin e investimit, nga Komanda e Forcës Ajrore është kërkuar miratimi dhe çelja shtesë për vitin 2011 në vlerën 7,775,280 lekë me TVSH, si dhe vlera 2,040,121 lekë e ngelur pa u realizuar nga kontrata, gjithsej në total 9,815,401 lek me TVSH. Kërkesa për miratime dhe çelje të fondeve janë bërë për shkak të punimeve të paparashikuara në projekt-preventivin bazë, të hartuar nga Instituti i Studimeve dhe Projekttimeve të Mbrojtjes (ISMb).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nga verifikimi i situacioneve të likuiduara, në mungesë të llogaritjeve metrike të librezave të masave u konstatua pasaktësi në situacionet përfundimtare të kontraktorit "I.C", duke përfituar padrejtësisht vlera prej 2,086,296 lekë, për shkak të pasaktësive në llogaritje të volumeve. Ky problem lidhet me rekomandimin e lenë më poshtë në piken C.II.3 (trajtuar më hollësisht në faqet 144-147 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

12. Rekomandim:

MM dhe Komanda e Forcave Ajrore, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik me pa mundësi arkëtimi **në shumën 2,086,296 lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

13. Gjetje. Dosja e teknike të zbatimit me objekt "*Rikonstruksioni i godinës dhe ndërtimi rrjeteve inxhinierike të AISM*", dhe shtesën e kontratës "*Rikonstruksioni i nyjeve hidrosanitare*". Gjatë zbatimit të punimeve, nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi, janë hasur problematika të cilat kanë kërkuar bashkëpunimin e Autoritetit kontraktor, pasi është konstatuar se të gjitha nyajt hidrosanitare janë të amortizuara për shkak të lagështirës që kanë muret dhe tavanet. Me shkresën nr. 37/1, datë

28.12.2016, nga IGJIU, i kthehet përgjigje AISM dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MM, ku sqarohen se problematikat në objekt qëndrojnë dhe është e nevojshme për ndërhyrje. Gjithashtu sqaron se problematikat nuk janë teknikisht të pandashme nga kontrata bazë dhe mund të kryhen edhe në një moment të dytë, por për shkak të natyrës së sigurisë IGJIU gjykon të përshtatshme që këto punime të kryhen në fazën e zbatimit.

Nga auditimi i preventivit të shtesës së kontratës, u konstatua se çmimet janë përcaktuar sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Pra nga KVO dhe nga MM, nuk janë marrë parasysh çmimet e kontratës fillestare, duke krijuar një projekt-preventiv të ri bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015, duke mos u referuar dispozitave ligjore të kontratës fillestare dhe rregullave të prokurimit publik. Nga krahasimi i çmimeve të kontratës fillestare dhe të shtesës, u konstatuan ndryshimet e çmimeve më të larta për disa zëra punimesh dhe më të ulëta për disa të tjerë, ku vetëm rritja e çmimeve të kontratës rezulton në vlerën **264,019 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 152-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

13. Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për rritjen e kostove buxhetore **në vlerën 264,019 lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

Ç.II. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje. Ministria e Mbrojtjes gjatë periudhës objekt auditimi ka realizuar procedura prokurime civile prokurime ushtarake dhe procedura prokurimi të klasifikuara *sekret shtetëror*, si më poshtë:

1.1. Procedurat e prokurimi për mallra shërbime dhe punë të realizuara në zbatim të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik":

-Në vitin 2015 në 29 raste me fond limit në vlerën 1,078,534,329 lekë dhe janë lidhur 29 kontrata në vlerën 840,883,149 lekë. Janë kursyer 327,651,180 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 22% e fondit limit.

-Në vitin 2016 në 48 raste me fond limit në vlerën 1,777,360,822 lekë dhe ka 48 lidhur kontrata në vlerën 1,062,626,399. Janë kursyer 714,734,423 lekë fonde buxhetore ose është kursyer 40% e fondit limit.

-Në vitin 2017 në 29 raste me fond limit në vlerën 1,118,311,719 leke dhe ka 29 lidhur kontrata në vlerën 904,153,150 lekë. Janë kursyer 214,158,570 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 19% e fondit limit.

1.2. Procedurat prokurimi për mallra shërbime dhe punë të realizuara për qëllime ushtarake:

-Në vitin 2015 në 5 raste me fond limit në vlerën 483,262,375 lekë dhe ka lidhur 5 kontrata në vlerën 427,482,350 lekë. Janë kursyer 55,780,025 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 11.5% e fondit limit.

-Në vitin 2016 në 12 raste me fond limit në vlerën 1,786,316,355 lekë dhe ka lidhur 12 kontrata në vlerën 1,782,466,020 lekë. Janë kursyer 3,850,335 lekë fonde, ose është kursyer 0.2% e fondit limit.

-Në vitin 2017 në 6 raste me fond limit në vlerën 4,712,951,520 lekë dhe ka lidhur 6 kontrata në vlerën 4,696,189,110 lekë. Janë kursyer 16,762,410 lekë fonde, ose është kursyer 0.3% e fondit limit.

Të gjitha këto procedura janë zhvilluar me procedurë me negociim të drejtpërdrejtë apo të kufizuar në zbatim të VKM nr. 521 datë 08.08.2007 "Për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit Publik", i ndryshuar. Siç shihet efektivitetin e këtyre procedurave nga realizimi i prokurimeve është pothuajse minimal.

1.3. Procedurat e prokurimit të realizuara, "*sekret shtetëror*":

-Në vitin 2015 në 10 raste me fond limit në vlerën 549,230,000 lekë dhe ka lidhur 10 kontrata në vlerën 545,779,000 lekë. Janë kursyer 3,451,000 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 0.6% e fondit limit.

-Në vitin 2016 në 8 raste me fond limit në vlerën 270,285,000 lekë dhe ka lidhur 8 kontrata në vlerën 268,395,000 lekë. Janë kursyer 1,890,000 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 0,7% e fondit limit

-Në vitin 2017 në 8 raste me fond limit në vlerën 477,431,000 lekë dhe ka lidhur 8 kontrata në vlerën 474,179,000 lekë. Janë kursyer 3,252,000 lekë fonde buxhetore, ose është kursyer 0.7% e fondit limit.

Të gjitha këto procedura janë të klasifikuara në nivel sekret “I kufizuar” dhe janë realizuar në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe VKM nr. 701, datë 22.10.2014 “Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”. Të gjitha procedurat janë zhvilluar me procedurë me negociim të drejtpërdrejtë apo të kufizuar në zbatim të VKM nr. 701, datë 22.10.2014 të sipërcituar. Edhe në këto procedura efektivitetin i prokurimeve është pothuajse 0 (zero).

Siç tregojnë të dhënat e mësipërme, për procedurat që i janë nënshtruar ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, pra janë zhvilluar në sistemin elektronik të APP, efekti i garës nga konkurrenca është dukshëm pozitiv dhe kjo tregohet mbi të gjitha në kursimin e fondeve që shkon nga 19 % deri në 40%. Ndërsa për procedurat që nuk i nënshtruar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, pra nuk janë zhvilluar në sistemin elektronik të APP, por me “Zarfe në dorë” efekti i garës nga konkurrenca, është dukshëm negative, çka tregohet mbi të gjitha në fitimin e tenderëve me vlerë të plotë dhe kursimi i fondeve në këto raste është 0.2% deri në 0.7%. Risku në procedurat e prokurimeve ushtarake dhe të klasifikuara sekret “I Kufizuar” në krahasim me procedurat prokurimit sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 është shumë i lartë sepse në këto procedura negociohet direkt me operatorin të parazgjedhur fitues. Duhet theksuar se, të gjitha procedurat e prokurimit si ato civile, ushtarake apo sekrete janë realizuar nga të njëjtët Komisione të Hartimit të DT dhe të njëjtët Komisione Vlerësimi të Ofertave. Për të nxjerrë në dukje efektet negative që kanë ardhur në dëm të buxhetit e shtetit si pasoje e punës me dy standarde të Autoritetit Kontraktor, morëm në analizë duke ilustruar, disa zëra konkrete të disa mallrave shërbimeve dhe punëve të realizuara nëpërmjet procedurave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe i krahasuam me të njëjtat zëra të disa mallrave shërbimeve dhe punëve të realizuara nëpërmjet procedurave ushtarake dhe sekrete. Nga ky krahasim dhe llogaritje rezultoi se, kostot e mallrave, shërbimeve dhe punëve të realizuara me procedurat e prokurimeve ushtarake dhe të klasifikuara sekret “I Kufizuar” janë minimalisht, rreth 10-20% ose në vlerë rreth **1 miliard lekë** më të larta, për shkak se, këto mallrave, shërbimeve dhe punë nuk janë prokuruar nëpërmjet sistemit elektronik të APP (në vitin 2015, rreth 120 milion lekë, në vitin 2016, rreth 240 milion lekë dhe në vitin 2017 rreth 640 milion lekë). Nisur nga këto probleme, kërkohet në mënyrë imediate marrja e një sërë masave për përmirësime ligjore sepse është pikërisht baza ligjore që lejon realizimin e procedurave pa konkurrencë, vakumi i të cilave është shfrytëzuar mjaftë mirë nga AK, duke sjell kështu, efekte negative të konsiderueshme në dëm të buxhetit të shtetit (*trajtuar më hollësisht në faqet 67-72 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

1. Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për rritjen e kostove buxhetore në dëm të buxhetit të shtetit **në vlerën rreth 1 miliard lekë.**

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

2. Gjetje. “Kompletimi me uniforma stërvitje e materiale të tjera pjesë e kësaj uniforme për strukturat ushtarake të FA-së”, për periudhën 2018-2021, me fond limit në vlerën 1,483,395,642 lekë, realizuar në vitin 2017.

Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes është ngritur grupi i punës për studimin e disponueshmërisë dhe analizës së kostos për blerjen e uniformave të stërvitjes e materialeve të tjera, pjesë e kësaj uniforme

për strukturat ushtarake të Forcave të Armatosura. Grupi i punës pasi studioj faqe të ndryshme të eeb-siteve të disa kompanive të huaja prodhuese të cilat operojnë në këtë fushë vendosi të dërgoj në rrugë zyrtare dhe elektronike kërkesën për çmime dhe disponueshmëri 7 kompanive. Kërkesës për çmim dhe disponueshmëri i janë përgjigjur të 7 kompanitë, duke sjellë çmimet e tyre. Gjashtë nga këto kompani kanë dërguar çmimet për të gjithë artikujt e kërkuar, ndërsa kompania “K.I”, Itali ka dërguar çmimet vetëm për artikujt e këpucëve të cilat i kishte paraqitur me çmime më të ulta se, të gjashtë kompanitë e tjera. Grupi i punës vendosi që çmimet për llogaritjen e fondit limit të jenë mesatarja e, çmimit të kontratës së mëparshme; çmimit mesatares së nxjerrë nga kompanitë /distributorët online; çmimit mesatar i kompanive të zgjedhura për çmim dhe disponueshmëri dhe në përfundim, llogariti fondin limit në vlerën 1,483,395,642 lekë. Po kështu ka sugjeruar që procedura e prokurimit të zhvillohet e “Kufizuar” me pjesëmarrjen e **të 7 kompanive që u kërkojë çmime dhe disponueshmëri**. Në vijim, është miratuar prokurimi i këtij projektit nga Ministri i Mbrojtjes dhe nga DSM është dërguar i gjithë praktika dokumentare e prokurimi në DAP për të vijuar me zhvillimin e procedurës së prokurimit. Kjo Drejtori, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dërguar i ka kërkuar DSM disa sqarime dhe plotësim dokumentacionit të kësaj procedure. Ndër sqarimet me kryesore është: *“shoqëria “K.I”, Itali e cila ka dhënë ofertë për artikujt që zënë një vlerë përafërsisht 30% të fondit limit, çka vë në diskutim edhe mundësinë e nën kontraktimit për pjesën tjetër të artikujve, pasi referuar “Kushteve të përgjithshme të Kontratës”, pjesë e DST që aplikon AK, nën kontraktimi lejohet për një vlerë jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës...”*?. DSM, mori në konsideratë këtë sqarim dhe bëri një ndryshim në propozimin e mëparshëm duke mos e ftuar këtë shoqëri për të paraqitur ofertën e saj, pra nga 7 kompani ftoi për të paraqitur ftesën për ofertë vetëm 6 kompani. Mirëpo argumentim i AK, për mos të ftuar kompaninë “K.I”, Itali në procedurën e prokurimi është bërë në interpretime të gabuara të VKM nr.521, date 8.8.2007 i ndryshuar, sepse, siç u trajtua më lartë, sipas pikës 1 të kreut VII të kësaj VKM që bënë fjalë për “Ekzekutimin e kontratës”, nënkontraktimi behet nga operatori që del fitues dhe që me dorëzimin e ofertave duhet të deklarojë punët shërbimet ose mallrat që ka për qëllim të nënkontrakttojë në rast se ai do të shpallet fitues. Pra nënkontraktorët nuk marrin pjesë në konkurrim (prokurim) por ofertuesi duhet ta deklarojë që një pjesë të kontratës do ta japi me nën kontraktim. Pra, kompanisë “K.I”, Itali, duhej ti dërgohej ftesa për ofertë, dhe në rast se, ajo gjykonte për të marrë pjesë në prokurim, për artikujt e tjerë që nuk kishte paraqitur çmime dhe disponueshmëri, fare mirë mundë të bënte bashkim operatorësh, ashtu siç ka bërë edhe kompania fituese të cilës i është dërguar ftesa për ofertë e vetme, por në prokurim është paraqitur si bashkim i tre operatorëve dhe KVO e ka shpallur fitues edhe pse VKM nr. 521, date 8.8.2, ndryshe nga rregullat e prokurimeve civile nuk parashikon rastet e bashkimit të shoqërive në një të shoqëri të vetme. Konkretisht, në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 18.12.2017, paraqitën dhe dorëzuar oferta vetëm 3 (tre) Kompani: “L” me ofertë në vlerën 1,481,013,520 lekë, BOE “D&T M & A”, me ofertë në vlerën 1,479,495,980 lekë dhe “A” me ofertë në vlerën 1,481,173,150 lekë. Është shpallur fitues me të cilin është lidhur dhe kontrata e furnizimit BOE “D&T M & A”, me ofertë në vlerën 1,479,495,980 lekë, pa TVSH. Por, për shkak të mos dërgimit të i ftesës për ofertë të kompanisë “K.I”, Itali, grupi i auditimit mori në analizë, çmimet dhe vlerat e artikujve të këpucëve, sipas ofertës fituese dhe i krahasoi me çmimet e kompanisë “K.I”, Itali të paraqitur në kërkesën për çmime dhe disponueshmëri dhe rezultoi se, çmimet e artikujve të këpucëve të kësaj kompanie ishin rreth 80 milion lekë më të ulta se çmimet e artikujve të këpucëve të ofertës fituese BOE “D&T M & A”. Për pasojë nga mos marrja pjesë në mënyrë të padrejtë të kompanisë “K.I”, Itali mund të ishte ulur rritur kosto e blerjes së këtyre materialeve ushtarake në **vlerën rreth 80 milion lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 121-128 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

2. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për rritjen e kostove buxhetore **në vlerën rreth 80 milion lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

3.Gjetje. Nga auditimi i pasqyrës financiare te Komandës së Forcave të Armatosura, si dhe nga verifikimi në terren nga grupi i auditimit në Bazën Ajrore, Farkë, u konstatua se është bërë ndërtimi i veprës me objekt “Ndërtim Hangar Mirëmbajtje për Helikopterët” në vlerën 70,025,172 me TVSH, ku është likuiduar subjekti për vlerën **67,897,522 lekë me TVSH**, i cili nuk është marrë ende në dorëzim. Hangari deri në momentin e auditimit në terren nuk përdorej madje kishte pësuar dhe dëmtime nga kushtet atmosferike nga erërat e forta ishte dëmtuar mbulesa e sipërme dhe vetrata anësore e hangarit, ku si rezultat i kësaj gjendjeje të gjithë helikopterët që ishin planifikuar për t'u strehuar momentalisht brenda këtij hangari janë alokuar në ambientet e jashtme të bazës, pavarësisht së nga baza ishin marrë masa për sigurinë fizike të tyre. Ambienti i jashtë për helikopterët, ndikon negativisht në pjesët e tyre fizike. Kontrata dhe projekti është i papërfunduar, ku zërat janë ngelur pa realizuar dhe punimet që kërkohen për përfundimin e objektit janë: *punime për instalimin e sistemit të ajrit të komprimuar së bashku me furnizimin dhe montimin e pajisjeve; punime për instalimin e sistemeve hidrosanitare dhe montimin e pajisjeve; punime për instalimin e pajisjeve të hapjes e të mbylljes së dymëve; punimet për instalimin dhe vendosjen e sistemit elektrik; punime për lmyerjen e hangarit me bojë si dhe të dymëve (trajtuar më hollësisht në faqet 59-60 dhe 144-147 të Raportit Përfundimtar të auditimit). Ky problem lidhet dhe me rekomandimin e lenë më lartë në piken C.I.12.*

3.Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përfundimin e veprës e cila nuk është funksionale dhe i ka kushtuar buxhetit të shtetit deri tani në shumën 67,897,522 lekë me TVSH. Nëse nuk merren masa për të përfunduar objektin si dhe marrjen në dorëzim, **shuma prej 67,897,522 lekë përbën dëm ekonomik i parikuperueshëm në dëm të buxhetit të shtetit.**

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

4. Gjetje. “Rikonstruksion i mensës së pilotëve në Bazën Ajrore, Farkë Loti II”, të realizuar në vitin 2016, me fond limit në vlerën 9,824,170 lekë, me operator të shpallur fitues “K” me vlerë oferte 7,538,095 lekë.

AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse në DT ka vendosur disa kritere të veçanta kualifikuese të cilat nuk janë hartuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet, janë hartuar, kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Ndër të tjera është kërkuar që, operatorët ekonomik duhet të dëshmojë se kanë të punësuar punëtor të kualifikuar si: “hidraulik, mekanik, punëtor/specialist ndërtimi, bojaxhi, etj. Të gjithë këta punonjës duhet të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi, diplomë shkollë, certifikata kualifikimi, trainime, etj, dhe duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar (janar – qershor 2016). Vendosja e këtyre kërkesave është bërë shkak për s'kualifikim të padrejtë të 3 operatoreve pjesëmarrës në procedurën prokurimit. Konkretisht, në tenderin e zhvilluar në datën 05.09.2016 kanë marrë pjesë 9 operatore ekonomik, janë s'kualifikuar 3 operatorë vetëm se nuk kanë plotësuar kriteret të veçanta që kanë të bëjnë me mosparaqitjen e dokumentacionit që të vërtetojnë se, operatorët kanë pjesë të stafit punonjës të kualifikuar (“elektricit, hidraulik, mekanik”, etj.) si: dëshmi, certifikatë ose diplomë që të vërtetojnë kualifikimin profesional të tyre, apo dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI. Mirëpo, këto kritere të veçanta siç u tha janë vendosur të ekzagjeruara dhe në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse këta operatorë për të vërtetuar se, kanë eksperience në këtë fushë duhet të paraqisnin dhe i kanë paraqitur kontratat e ngjashme, të cilat janë mese të mjaftueshme për treguar se, këto operatorë kanë kryer më parë me sukses punë të ngjashme të kësaj natyre. Duke ju referua edhe pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” këto mangësi të, konsiderohen lehtësisht devijime të vogla dhe nuk e pengojnë operatorin dhe nuk

ndikojnë në ekzekutimin e kontratës, sepse objekti i kontratës është “Rikonstruksion mense” dhe kryerja e punimeve nuk kërkon punëtorë të kualifikuar të pajisur me certifikata, dëshmi apo diploma shkolle, por mjafton që të kenë kontratë pune dhe të jenë të regjistruar në sigurime shoqërore. Nga këto veprime i **është rritur kosto e buxhetit të shtetit në vlerën 920,408 lekë, me TVSH**, e cila llogaritet nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit fitues me diferencën e vlerës së ofertës së operatorit “SH” të s’kualifikuar padrejtësisht i cili kishte paraqitur ofertën më të ulët se operatorët e tjerë që duheshin kualifikuar.

4. Rekomandim

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për rritjen e kostove buxhetore **në shumën 920,408 lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

5. Gjetje: Në Ministrinë e Mbrojtjes ka vende vakante për të cilën është kërkuar pranë DAP hapja e konkurimit për plotësimin e tyre. Nga Ministria dhe nga DAP nuk është marrë asnjë masë që punonjësit në listë pritje dhe që vazhdojnë të paguhen nga buxheti i shtetit të bëhet sistemimi i tyre në këto vende vakante, po kërkohet të plotësohen me staf të ri, ndërkohë për një pozicion pune janë paguhen dy persona, i punësuar aktual dhe personi që është në listë pritje apo që ka fituar gjygin për tu rikthyer në atë pozicion ose ekuivalente me pozicionet e mëparshëm, duke rënduar kështu padrejtësisht buxhetin e shtetit ku vetëm për një vit nga ky veprim, kosto buxhetore është rritur rreth 13,651,200 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 19-26 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

5.Rekomandim:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për rritjen e kostove buxhetore në **vlerën 13,651,200 lekë**.

D. MASA DISIPLINORE E ADMINSTRATIVE

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” dhe në mbështetje të Kreu III-të “Sanksionet” të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, i rekomandojmë Ministrin të Mbrojtjes:

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjekë me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë masat që do të marrë Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e rekomandimeve të këtij auditimi, reflektimin e tyre dhe përmirësimin e punës dhe proceseve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar, në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Shënim:

Në Raportin Përfundimtar të auditimit dhe në këtë Vendim, nuk janë trajtuar procedurat e prokurimit të realizuara në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar **“Sekret**”

shtetëror” dhe VKM nr. 701, datë 22.10.2014 “Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

